REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

| Pranuar - Primljeno Me Dana | 18-06-2025 | | |
|---|---|---|---|
| Nr. i organit Org. Broj | Numri Broj | Shtojce Prilog | Vlera Vrednost |
| 01- | 060/ | 01- | 636 |

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 të Ligjit Nr. 03/L – 040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/15, Qershor, 2008) dhe të nenit 30, paragrafi 30.2 të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011, dhe të nenit 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendit të komunës, në nenin 6, pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/594, e datës 02.05.2014, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

# F T E S Ë

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e **VI** të rregullt të Kuvendit të Komunës së Vitisë, që do të mbahet me datën **30.06.2025 (e Hënë),** duke filluar në ora 10:00.

Mbledhja do të mbahet në Sallën e Kuvendit të Shtëpisë së Kulturës "Gursel e Bajram Sylejmani" në Viti. Mbledhja është e hapur për publikun. Për këtë seancë kryesuesi propozon këtë:

## R e n d d i t e

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e pestë e Kuvendit Komunal.**
2. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) të Komunës së Vitisë 2026-2028.**
3. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për themelimin e grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës së Vitisë për vitin 2026.**
4. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shfuqizimin e vendimit për miratimin e planit nderkomunal për Menaxhimin e integruar të mbeturinave për komunat e Gjilanit, Kamenicës, Vitisë, Novobërdës, Parteshit, Kllokotit, Ranillug, Ferizaj, Kaçanik, Shtime, Han I Elezit, Stërpcë, vendimi me nr. 01-110/05-402 e datës 30.04.2025.**

**Viti, më 18.06.2025**

**Kryesuesi i Kuvendit**
**Bekim Azizi**

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

# PROCESVERBAL

## I MBLEDHJES SË PESTË TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhja u ftua dhe u kryesua nga z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Ajo u mbajt më **27.05.2025 (e martë)**, në Shtëpinë e Kulturës "Gursel e Bajram Sylejmani", duke filluar punimet në ora **10:00.**

Në mbledhje morën pjesë: kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi; nënkryetari i Komunës, z.Hasan Aliu; këshilltarët e Kuvendit: z.Ramadan Deliu, znj.Valentina Mehmeti, zn.Zejnepe Osmani, z.Sokol Hyseni, z.Ilir Zuka, z.Ekrem Ymeri, zn.Arbnora Hajredini, z.Sokol Shaqiri, z.Basri Sylejmani, z.Jakup Demiri, zn.Liridona Bislimi, z.Sejdi Emini, z.Nexhat Halili, z.Remzi Salihu, znj.Majlinda Shabani, z.Musli Neziri, zn.Vilsona Maliqi-Salihu, zn.Zyrafete Rama, z.Reshat Azizi, z.Taulant Haxhiu, znj.Anisë Zejnullahu, z.Veton Ramadani. Pjesëmarrës të tjerë: drejtorët e drejtorive komunale, përfaqësues të Zyrës së Kryetarit, përfaqësues të mediave elektronike dhe të ftuar të tjerë. Munguan: zn.Marigona Avdiu, z.Durim Sylejmani, zn.Lindita Demelezi, z.Ali Bajrami. Pasi u konstatua prania e 23 anëtarëve të Kuvendit Komunal, kryesuesi e shpalli të hapur mbledhjen, duke theksuar se pritet që edhe anëtarë të tjerë të bashkohen gjatë zhvillimit të saj.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e pestë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Gjatë kësaj periudhe kohore, nuk kemi pranuar ende vlerësimin e ligjshmërisë së akteve të miratuara në seancën e kaluar. Besoj që ne afatin prej 30 dite na njoftojnë. Para se të hymë në rend të ditës, kemi pjesën për pyetje dhe përgjigje. Fjala është për juve.

**z.Ramadan Deliu:** Përshëndetje për të gjithë. Unë atë ditë në PKF e kam kërku me i liru edhe zjarrfikësat, edhe FSK-në nga pagesa si policinë. Nuk po e shof që e keni shti. Tash propozoj që me e fut në rend dite.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Kur të vijmë te kjo pikë e propozojmë edhe e plotësojmë këtë kërkesë.

**z.Ilir Zuka:** Përshëndetje të nderur të pranishëm! Unë për këtë seancë kam dy pyetje. E para, ka të bëjë me rrugën "Sabit Alidema". Na e dimë që vitin e kaluar e kemi ba rrugën Qifllak-Navosellë, edhe u bë jashtëzakonisht mirë, për shkak se në atë pjesë u lidhë edhe Pozharani. Po tash është një shqetësim i madh nga banorët, se në atë rrugë po ka njerëz që po vozitin jashtëzakonisht shpejt, po vozisin pa patent shofer, për shkak se po i lidh tri fshatra dhe nuk po kalon ka rruga kryesore, dhe sipas atyre qytetarëve, po bëhet kontrabant e madhe. Andaj, kërkoj nga instocionet e komunës sonë, që të ndërmarrin diçka, se ajo rrugë, siç po thojnë ata banorë, ka me e sjellë vdekjen e fëmijëve, sepse ajo rrugë nuk ka trotuar. Edhe pyetja e dytë, për drejtorin e urbanizmit. Drejtor, ne e kemi kompletu një pjesë të madhe të numrave. Po e dimë që ki shumë shpija në Pozharan që kanë mbetë pa numra. A pritet mu vazhdu kjo pjesë? Është rruga "Sabit Zuka" që ka mbet një pjesë pa numër, një pjesë te lagjeja "Halabaku", dhe të rruga "Ibrahim Pira" me duket nuk janë përfundu krejt.

**z.Jakup Demiri:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Unë kam tri pyetje për këtë seancë. Objektet të cilët pikin kur ka kohë me shi, dhe gjatë kohës së dimrit, këto objekte të cilat janë nënë kompetencë të komunës. A kanë një raport me e pa se cilat objekte i kanë këto problematika. Disa vetëm i kam cek në muajin e kaluar, për shkak se veçmas pak kohë pas mbledhjes, komunën e re e ka vërshu uji, ndërsa aty muj me thanë që nja 6-7 vjet ka qenë ky problem, mandje për një intervenim krejt të vogël na vjen edhe me u dëmtu objektet të cilat do nuk i kanë as 10 ditë që janë ndertu, e disa edhe janë riparu, edhe që kanë qenë ekzistuese. Po me ditë cilat i kanë këto problematika. Tek trotuaret në Smirë, Trestenik, e disa trotuare të cilat vetëm që kanë hi në vitin e 4-ër të pa përfunduar, ndërsa ka vende, trotuare të reja që po fillojnë. Kisha thanë që të kryhen njëhere qato, se për Smirë

po thamë, që 4 vite është trotuari i nisur dhe ka pas edhe aksidente të fëmijëve e të pleqëve me ato trotuare që e kanë lan në gjendje të keqe, të rrezikshme per ata që hecin aty pari. Edhe e kam një shqetësim tek salla e kurorëzimit, tek komuna e re. Atje a është funksionale dhe a kryhen aty apo vetëm është bë salla e nuk funksionon? E kam këtë pyetje nga një qytetar. Këto po e lidhi, se edhe kur ju ka dhanë salla e kurorëzimi nuk ju ka dhanë të parit, po të dytit, i cili ka qenë 50% me i shtrejt, d.m.th opoeratorit të dytë. Po unë po pyes; a është funksionale apo jo? Dhe një pyetje për nënkryetarin. Tek kontratat e projekteve për hartimin e projekteve. E kam kërku një listë, cilat projekte janë hartu prej qatyre projekteve. Nëse i ka pru, nënkryetari me ka thanë që në këtë seancë e sjelli, sepse shuma që janë bë projektet, është dikun 844 mijë euro për hartim të projekteve, dhe na po e dimë se në çfarë gjendje i kemi projektet.

**z.Nexhat Halili:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Pyetjen e parë e kam për drejtorin e shërbimeve publike. Veç sezona pranverore gati se përfundoj, tash fillon sezona verore. Shumë rrugë në Komunën e Vitisë i ka kapluar rritja. Bari duhet të shkulet, dhe shumë mbeturina të ndryshme. Tani veç muaji i pestë ka kalu, nëse nuk veprohet në këtë drejtim, atëhere mundet të paraqiten gjarprinj, zvarranik etj. Kontratën e keni të lidhur me datën 08.08.2024 deri me 07.08.2026, ku vlera e kësaj kontrate është 199 mijë e 970 euro. E pyetja kryesore është: a keni ndonjë plan se cilat rrugë keni me i pastru? Apo deri tani unë nuk po shof se keni dalë në teren dhe është duke u bë pastrimi i rrugëve, deri sa në kontratë i keni të parapamë dikun deri në 300 kilometra për pastrim të barit. Pyetja tjetër ka të bëjë me asfaltimin e rrugës "Anton Qeta", deri te rruga "Sejdiu" në fshatin Stubëll të Epërme, faza e dytë, ritender, vlera e planifikuar ka qenë 550 mijë, vlera e kontratës 822 mijë e 858.14 euro, kontratë dyvjeçare prej 29.09.2022 deri 22.09.2024. Në listën e investimeve në vijim, në muajin e kaluar është potencu se, këtu ka pas probleme me banorët e këtyre lokaliteteve, mirëpo në fund është zgjidh problemi i kësaj problematike. Mirëpo pyetja ime është: a ka fillu implementimi i kësaj rruge? Deri ku ka arritë realizimi i kësaj rruge? Sa është bë pagesa për këtë rrugë? Sa ka mbet pa u pagu? Edhe sa ka mbetë pa u realizu? Ku tek trotuaret e potencoj Jakupi më herët, unë i kam nja dy fotografi të tretuarit në Trestenik, ku ka fillu të lulëzoj bari, që është rrezik për të ardhmen, plus në anët tjetër edhe uji po volit në ato vende, kështu që, ju bëjnë apel që, sa më shpejtë të intervenoni ta rregulloni këto trotuare, se si duket kjo ka kalu një kohë shume e gjatë dhe nuk po merret kur far hapi në këtë drejtim.

**z.Musli Neziri:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Pyetjen e parë e kam për DKA-në. Meqenëse drejtoresha është në mungesë, nënkryetari besoj që eshtë në rrjedha. Jemi në fund të mësimit shkollor dhe punimet në objektin e gjimnazit, edhe këtë vit nuk u kryten dhe e dimë që është çrregullu procesim mësimor. Aty me sa e di jemi krejt për disa punë teknike, e ku nuk kanë mujt me kalu nxënësit në atë objekt, prandaj krej çka po kërkoj, sepse është kërkesë edhe nga Këshilli Komunal i Prindërve, të cilin e përfaqëosj. Aty ka qenë një kërkesë që, deri kur kanë mrri punimet aty dhe çka është problemi që nuk po fillon mësimi, dhe a pritet që në muajin shtator nxënësit e gjimnazit të fillojnë aty. Edhe pyetjen e dytë e kam rreth problemit me ndriçimin publik në rrugën "14 Qershori" në Viti. Ka disa javë që është ndërpre ndriçimi aty. E kam njoftu ingjinierin e komunës, Xhelal Musen, dy here e kam kontaktu në telefon. E di që ai nuk të koka prezen këtu. Po kërkoj që ajo rrugë të ketë një kujdes, sepse në mungesë të ndriçimit trotuar nuk ka. Shpejtësia e automjeteve zhvillohet kogjo shumë, besoj se një pjesë e madhe e frekuentojnë në kam atë rrugë që hecin, prandaj po është shumë e rrezikshme në kohën e mbrëmjes kur po mungon ndriçimi. Nuk e di se si ka ardh problemi, po në momentin që është ndreq, janë bë rregullimet knej nga lumi. Andej janë ndal dikun, është një defekt, ndoshta një ndërhyrje shumë e shpejt eliminohet ai problem.

**znj.Majlinda Shabani:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Edhe unë i kam disa çështje që duhet ti adresoj sot. Me investimet e fundit që jan tu bë në Komunën e Vitisë, konkretisht në infrastrukturë, ku muj me pa, edhe jemi dëshmitar se, çfarë investime po bëhen pa planifikim, që në fakt vetëm po ja vështirësojnë jetën qytetarëve. E kemi rrugën, e kemi potencu disa here rrugën rreth lumit "Morava", që është duke u shtru me kupza. Përpos kësaj, edhe pjesa tjetër, d.m.th deri te komuna, që kish vazhdu me u punu. Pyetja ime është, me çfarë ideje, me çfarë planifikimi është bë ky investim. Edhe nuk e di se qysh mendoni ju, se qajo rrugë ka me ju hy në punë qytetarëve, dhe me ja lehtësu jetën qytetarëve, e ku në fakt qytetarët qysh tani janë tu pas problem. E në anën

tjetër po i bllokojmë edhe bizneset që janë përrreth aty. Se sa shumë ja keni vështirësu veprimtarinë që ata e bëjnë. Realish ky investim që është bë në Komunën e Vitisë, është investim pa kurnifar planifikimi dhe investim që vetëm ja ka vështirësu jetën qytetarëve të Komunës së Vitisë. Çështja e dytë është rregullimi i trafikut. Mungesa e shenjave të trafikut dhe problemin me parkingje që e kemi tash e disa vite si shqetësim në komunën tonë, dhe po besoj që është koha dhe momenti, se më shumë kurrë kryetari i komunës me e hek vëmendjen pak prej betonizimit, dhe me e kthy pak vëmendje edhe në qeto investime që duhet me u rregullu për jetën e qytetarëve, që kanë qasje për secilën ditë. Është problem që mundet me u rregullu për një kohë shumë të shkurt me drejtorinë përkatëse, që i takon edhe thjesh me e kthu vëmendje, sepse jemi tu e pa se çfarë kaosi është shndërru qendra, dhe hiq ma larg se tani, tu ardh në seancë të kuvendit komunal, pati aksident në udhëkryq, e madje u blloku komplet aty, dhe unë pata problem për me mrri me ardhe në seancë. Dhe çështja e tretë ka të bëjmë me trajtimin e ujrave të zeza. Është një problem që, Komuna e Vitisë e ka tash e disa vite, edhe e kemi një kryetar që e kemi ripotencu, se e ka mandatin e tretë të qeverisjes, edhe nuk e kemi pa deri me sot në asnjë nismë serioze për me e zgjidh këtë probem, andaj unë nuk e di nënkryetar a mundesh me na thanë diçka me konkretisht, se çka keni bë rreth trajtimit të ujrave të zeza. A ka ndonjë nismë më serioze nga ana e komunës me na tregu se, çfarë investime keni bë në këtë çështje, edhe me e pa na se sa mjete financiare keni investu. Edhe e fundit ka të bëjë me një temë, që e kanë përmend edhe kolegët në seancën e kaluar, është publikimi i emrave të punësuar ne kohën e fundit përmes kontratave me Kosova Med dhe Karitasin. Kemi kerku edhe në KPF, un po kërkoj edhe sot që, ajo listë me u bë publike, sepse vet mos publikimi i asaj liste, tregon shumë për mënyrën e të punësuarve në Komunën e Vitisë, edhe nepotizmin e thellë që e ka kapluar Komunën e Vitisë, e sidomos në këtë kohë që jemi afër zgjedhjeve lokale.

**z.Basri Sylejmani:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Unë i kam tri pyetje. Në nji, është rruga "Hebib Sejdiu". Nëkryetar, kur është në pyetje asfaltimi, edhe rruga "Ibrahim Pira" në Pozharan, ajo ma ka hi në agjendë moti, po nuk është kry. Edhe në fshatin Binç është, Valericë i thojnë, e din Basria ku është ai vend, edhe aty ka kundërmim tepër të kanalizimit, për shkak se nuk është vendos kanalizimi.

**znj.Zejnepe Osmani:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Unë ju kisha drejtu Drejtorisë së Shërbimeve Publike, që ta dërgon një ekip që janë për kositjen e barin në palestrën sportive, që është në Drobesh, sidomos tek rrethi i atletikes.

**znj.Liridona Bislimi:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Nënkryetar, tek rruga **"Saqin Hoxha"**, në Sllatinën e Epërme, banorët e këtij lokaliteti kërkojnë që, kjo rrugë që e lidhë Sllatinen me Dardanin, e është një kërkesë e cila është dorëzu nga këta banorë tash e një kohë të gjatë, dhe për shkak se është interes i madh, nga ana e tyre kërkojnë me ditë se, a është shiku kjo kërkes, a është bë ndonjë analizë dhe kur planifikoni ta vendosni në implementim të buxhetit komunal. Çështja tjetër është shumë me rëndësi. Unë e di nënkryetar, që i preokupon të gjitha komunat, mirëpo, unë dua të flas konkretish për Komunën e Vitisë, për qenët endacak. Nuk e di a e keni iden se, çfarë problematike e madhe është, dhe a arrinë tek ju qytetarët. Me këto kërkesa e shqetësime kemi shume të ri e te reja, po edhe moshave të ndryshme, që punojnë herët në mëngjes, po sidomos orëve të mbrëmjeve, tash njerëzit po dalin edhe në shëtitore. Kam rast konkret prej fshatit tim, po edhe nga të tjerë këtu në shesh, po edhe një pjesë tjetër është bë si strehimore e qenve endacak. Po kërkoj me ditë konkretish për parashikimin buxhetor, për strehimin e qenve, edhe për sterilizim, normal edhe për vaksinim të tyre. E di se disa komuna kanë hartim të planit komunal për manxhim të qenve endacak. E di që shumë komuna kanë këtë problem me qenët endacak. Unë e shof shumë të rëndësishme këtë çështje, që, ndoshta kishte qenë mirë me bë një pikë të rendit të ditës, me diskutu për këtë temë, sepse duhet me u trajtu problemi me seriozitet, para se me ndodh ndonjë rast tragjik e me na prek të gjithve, edhe pse shumë jam ka frigohem që kemi me pas ndonjë ras që nuk kemi mu ndi mirë as ne.

**z.Ilir Zuka:** Për drejtoreshën tek QKMF-ja në Pozharan, pjesën e oborrit me marr dikush, me e kosit, me pastru, se ish be problem edhe për pacienta.

**z.Visar Demiri, drejtor:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Tek pyetja që ishte për numrat në objekte, ju e dini që procesi ka përfunduar i vendosjes së numrave. Është fotografimi i vitit 2018. Ai që e ka pamundësu

ndoshta, që në disa objekte e shtëpi të mbesin pa numra, po ky është proces që vazhdon bashkë me ndërtimet e reja që bëhen. Ne vetëm kemi disa qindra numra rezerv, të cilët mendojmë me i vendos gjatë verës tek objektet që përputhen me rend dite. Pastaj duhet me pa mundësinë që, vitin e ardhshëm me e përfshi në buxhet, dhe me porosit numra të ri për objektet që kanë mbet pa numra.

**z.Basri Aliu, drejtor:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Rreth pyetjes, rreth Drejtorisë së Shërbimeve Publike, u benën disa. Unë do të përgjigjem. Rritja e barit dhe largimi i tyre në rrugë, u përmend se është kontrata me qat vlerë që kish, nuk është për një vit, po për më shumë vite. Po me qenë më korrekt me këshilltarët, ne çdo here i kemi hek, po do t'i hekmi, pra, në rrugët kryesore, sepse në barnishta, nëpër vende tjera, unë vet kam pa që nuk largohen të gjitha, po vetëm aty ku paraqitet rrezikshmëria, kështu që, do të mundohemi dhe mbrenda jave, se edhe ashtu e kemi planifiku. Disa rrugë që u ceken, ndoshta edhe nuk janë tonat, janë të ministrisë. U përmen ndriçimi. Do të shofim, do të bisedoj, dhe shumë shpejt do të intervenojnë të zgjidhet ky problem. Tek parkingjet u cek, dhe të njëjtën kohë tha, mu ndal betonimet. E unë po i thamë se, edhe betonimet janë parkingje, po për parkingje ne kemi ba aq sa kemi mujt, po nuk do të thotë që nuk do të merrem me këtë punë.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Të nderuar të pranishëm! Me lejoni që të ju përgjigjem pyetjeve të juaja. E ndij veten obligativ ndaj dy këshilltarëve, të cilët nga seanca e kalume kanë kërku e ju kam sjell përgjigjen. Jakup, nuk kam dashtë me i ik, po kur ka qenë prezent atë ditë Zyra e Prokurimit. Kam mëndu që ki marrë përgjigjen kur e ki pas fjalën tek kontrata per hartimin e projekteve, dhe seancën e kalume e ki pas menagjerin e Zyrës së Prokurimit prezen, dhe Musli kam bë përpjekje maximale, po megjithatë nuk kam mujt me ardh në përgjigje, me tu përgjigj për çështje e defektit të kyqjes në rrugën magjistrale Gjilan-Ferizaj, që ish i njëjti problem, disa ingjiniera në aspekt privat që kam bisedu, po megjithatë nuk kam mujt me marr përgjigje adekuate. Ilir, tek çështja e rrugës "Sabit Alidema", është mirë drejtori i shërbimeve publike dhe inspeksionit, me pas parasysh, me dal në teren me vendos shenja, apo polic të shtrirë, duhet me shiqu. Objektet të cilat kanë probleme me rrjedhën e ujit, sakt ka me ti dhanë. E di që kemi pas probleme. Nuk kam informacion, se salla e kurorëzimit nuk është funksionale. Unë e di që është funksionale. Trotuaret në Smirë, Trestenik. Po besoj që e keni shterr atë ditë diskutimin me Zyrën e Prokurimit. Punimet tek gjimnazi, është çështje rryme. Besoj që shumë shpejt ka mu zgjedh. Të tjerat janë të kryme. Rruga me kubza. Jam në dijeni se, së shpejti do të intervenohet. Çështjen që e thu, nuk ka planifikim, nuk ka investim pa planifikim, po ndoshta ti nuk i shef. Është e vërtet që, në momentin që intervenohet ka tollovi. U tha, nuk keni bë kurgja në trajnimin e ujrave të zeza. Jo kemi ba shumë, po megjithatë do të bëjmë sërisht. E kemi projektin ndërkufitar, ku në mesin e tyre, përveç të disa pikave turistike, janë të futura edhe disa pika për trajtimin e ujrave të zeza. U kërkua publikimi i emrave të të punësuarve. Ti mundesh me kërku këtë drejtpërdrejt nga Kosova Med dhe nga Karitasi, se për shkak se ata janë që i kanë pranu, sepse ata i kanë emrat e të punësuarve. Rruga "Hebib Sejdiu", "Ibrahim Pira" është një realitet se, rrjedhën e realizimit të projekteve naj ka prishë kontrata kolektive, e cila naj ka marr parat edhe nga investimet kapitale, sherbime dhe mallra etj, etj, shumë projekte që kanë qenë të parapamë në realizimin naj ka shty. Liridonë, e kemi shqyrtu kërkesën, po e njëjta çështje është mungesë e buxhetit. Duhet me pas parasysh me rregullu edhe atë rrugë. Tek çështja e qenve endacak. E kemi një kontratë, vetëm kan fillu, e di që janë tu e trajtu, sepse na njoftuan në mbledhje të KKSB-së.

**z.Ilir Zuka:** Nënkryetar, tek rruga "Sabit Alidema", para dy vite ajo rrugë ka qenë vetëm rrugë e lagjes, me lidhjen që është bë, rruga për Terpezë-Qifllak-Navosellë, tu e ditë që edhe klubi i futbollit aty banë aktivitete, është rrugë tepër e ngarkuar, me pa mundësinë aty me e ba një trotuar.

**z.Nexhat Halili:** Nënkryetar, u deklarova se janë marr parat prej pagave, mëditjeve dhe investimeve kapitale, nuk e potencova prej mallrave dhe shërbimeve. Deklarove që kemi pas zyrtarin e prokurimit në seancë, po është e vërtet, po kur ja kam bë pyetjen për trotuarin në Trestenik, jo që nuk ka dhanë përgjigje, po edhe e ka neglizhu. Merre shikohe seancën e kalume.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Ti nëse i ki tri katër tema, ne seancën e radhës diskutojmë edhe serish ta sjelli zyrtarin e prokurimit, i cili i ka në domenin e tij këto çështje. Po, vetëm që, nuk po më pëlqen, se një njeri profesional si ti mu sjell rreth një boshti që një vit.

**z.Nexhat Halili:** Ështe e vërtet që e kam ngrit shpesh, por shifet se ju nuk po veproni, nuk e keni kry punën, kontrata ka përfundu. Tjetra, rruga "Anton Qeta", përgjigjja jote nuk ishte profesionale.

**z.Jakup Demiri:** Nënkryetar, e vërtet se e kemi pas shefin e Zyrës së Prokurimit në seancë, po ai e ka obligim në KPF me pru raport. Po në rregull, po ti më thave mu që, pëgjigjen e bi në seancë, edhe unë e pata një rast që mu desht me nderpre seancën, po unë nuk kam marr përgjigje, as në pyetjen tjetër që e kam bë muajin e kaluar.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Kërkesa juaj ishte e qartë, unë ta sjelli në seancën e radhës përgjigjen.

**z.Jakup Demiri:** Unë kësaj pune ka mi shku deri ne fund, sepse janë në pyetje 844 mijë euro të dhëna për projekte, e na e dimë mirë. Tek puna e komunës së re, para tri katër vite unë qetu kam fol për qeto problematika, e që ajo tash ka ardh e u trash problemi. Me pas intervenu atëhere, me një intervenim të vogël nuk kish ndodh qajo, e ndoshta na vjen puna edhe me objekte tjera me i pas të njëjtat telashe. Drejtor, tek pyetja e Muslisë, mujshi me e lidhë me Smirë, se atje që nja tri vite funksionon 24 orë ndriçimi publik, e nuk i ki ra mas kurrë asaj pune dhe nuk ki dhanë raport. E lidhe me ata a kanë rrymë. Pa problem, aty në Smirë edhe ditën rrinë dhezë dritat, e për mos punën e juaj paguajnë qytetarët. Kjo nuk është në rregull. Mundet me ndodhë një javë ose dhjetë ditë, po e kemi vitin e tretë ndriçimi në Smirë, i cili funksionon edhe ditën, edhe trotuari, i ki nja pesë gjashë raste që i kanë thy hunt fëmija e pleqtë, që nuk e keni përfundu kurrë ju.

**znj.Majlinda Shabani:** Nënkryetari u përgjigj në disa pyetje, të cilat nuk fërkojnë fare me realitetin. Po ndërlidhem me të paren, tek investimi që është bë tek lumi "Morava", me ndërlidh me atë që tha, pa planifikim, me planifikim. Nëse komuna, dhe nëse ju e keni planifiku, që qajo rrugë me qenë e shtrume me kubza në qat formë ku e vështirson jetën e qytetarëve, ai nuk është kurnifarë planifikimi adekuat, që ja lehtëson jetën qytetarëve. Nuk e di me çfarë logjike, nuk e di se propozim i kujt ka qenë, dil pyti qytetarët në qytet, në teren edhe tregoj ty se çfarë menimi ka për qët rrugë, dhe dil këshyri për çdo ditë veturat që kalojnë në atë rrugë, se çfarë vështirësije kanë. Mundet mu nis një punim me u bë e me u zgjat me shku me vite. Unë e kuptoj që kur te punohet dikun duhet me u blloku rruga, mirëpo jo me zgjat kaq shumë e me met pa e marr një epilog. Në fund, sa i përket planifikimeve që ju i bani si komunë, ju e keni një pasqyrë shumë të keqe që ka mbet edhe tek instituti GAP, që unë e kam edhe fotografinë këtu që figuron zero planifikime per investime kapitsale per vitin 2024. Qekjo është pasqyrë e keqe që i ka mbet Komunës së Vitisë, se tani ju mundeni me i pas planifikimet e juaja që ju i mendoni, se unë e di edhe mënyrën, logjikën se si funksionon Komuna e Vitisë nëse flasim me dokumente adekuate, e nëse folim me mënyrë se qysh ne e kemi pa që sa vite qysh funksionon Komuna e Vitisë, atëhere muj me fol pernime në bazë të argumenteve dhe materialeve që ju naj sjellni. Na e kemi pa edhe në seancat e kalume, para kësaj seance se, ku Komuna e Vitisë lidh kontratë milionshe për asfaltim të rrugëve, e ku nuk ka qenë në gjendje që sa vite qeverisje me i identifiku qato rrugë, që në fakt ish dash me i asfaltu. Unë pernime kam prit që, për kaq vite qeverisje, pernime që shtrohet një asfalt, e mos me pas nevojë me intervenu dy tri here në qat asfalt, po qasja e komunës me qenë edhe ndaj shërbimeve të tjera që duhet me i pas Komuna e Vitisë, e unë e pata fjalën jo vetëm për parkingje, po edhe për rregullimin e trafikut në Komunën e Vitisë. Në përgjithësi unë e di që, pak vullnet me pas e pak përkushtim e seriozitet në punën e juaj, kjo çështje ka qenë dashur me u rregullu brenda muajve. Sa i përket trajtimit të ujrave të zeza, ka qenë premtim elektoral i kryetarit Haliti, implioantet për trajtimin e ujrave të zeza. Edhe na e dimë gjendjen e trajtimit të ujrave të zeza, që është në komunën tonë, e nëse nuk më beson, mundesh me hi me e lexu raportin e punës që e kemi të kryetarit të komunës për vitin 2024, edhe tregon tek shërbimet publike, se në çfarë gjendje është trajtimi i ujrave të zeza, menaxhimi i mbeturinave, edhe se çka shkakton. D.m.th qeky mos menaxhim i mir që i bëhet komunës sonë, e sa i përket publikimit të emrave, ke shumë përgjigje qesharake. Unë ka me kërku qysh sot edhe me email zyrtarë që qato emera me u ba publike e me naj dërgu në email, edhe mandje kemi me pa haptas mënyrën e punësimit në Komunën e Vitisë.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Majlindë, çështja se kush e ka projektu, po të tregoj, e kemi projektu, edhe ka qenë me projekt për shtimin e kubzave, dhe ti e paske një grup të qytetarëve që munden me të besu që, të kokan të paknaqur. Po unë kam shumë më shumë se ti që janë të knaqur me punë të cilën po e banë komuna. Dhe çështja e qëndrueshmërisë së projekteve, kurrë nuk kam thanë që kemi projekte të qëndrueshme, por a ja

kalojmë nivelit qendror, tanit bile tonat shkoj 5-7 vite e tuat 5-6 muaj bile. Edhe në dinamik ne jemi shumë më të shpejtë se të nivelit qendror.

**znj.Liridona Bislimi:** Sa i përket rrugës "Saqit Hoxha", unë shpresoj mos të jet anash, për shkak se kjo e kish edhe një lidhshmëri me Komunën e Ferizajt. E Komuna e Ferizajt e ka marr me seriozitet dhe ka shpreh gadishmëri për me i hi kësaj pune. Kështu, mbetet nga komuna jonë implementimi i kësaj. Ndërsa tek çështja e qenve endacak, mu po më intereson me ditë nënkryetar, pak më shumë me pas informacione, me ma sjell kontratën me e pa.

**z.Basri Sylejmani:** Kolegët e mi të cilët asnjëhere nuk e kanë votu buxhetin, asnjëhere nuk kanë votu për rrugë, e tash lidhen që nuk janë kry punët. Po qysh nuk janë kry punët! Çdo vend janë kry. Ka mungesë, ama janë kry mase 80%.

**z.Jakup Demiri:** Për tek niveli qendror, kjo rruga Gjilan-Ferizaj ka qenë me këtë projektin evropian. Se tani nuk po me kujtohet emri prej 2011 ose 2012, po kurrë nuk ka kalu në qeveritë tjera, e kjo qeveri e ka kalu. Tek puna e buxhetit e Komunës se Vitisë. Më së pari votohet pa planifikim të investimeve kapitale. Sa i përket qenve endacak, me ligj ta obligon me i parapa mjetet në buxhet për trajtimin e qenve endacak, e që dy vite jemi tu e hup edhe grandin.

**z.Bekim Azizi, kryesues:** Faleminderit për kontributin! Materialin e keni marrë me kohë: a ka dikush me diskutu për rendin e ditës? Për këtë seancë kemi parapa këtë rend të ditës:

## Rend dite

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e katër e Kuvendit Komunal.**
2. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2024 në vitin 2025.**
3. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për lirimin nga pagesa e punonjësve të Policisë së Kosovës, për shërbimet që afrohen në Qendrën e Mjekësisë Familjare dhe institucionet e tjera shëndetësore që menaxhohen nga Komuna e Vitisë.**
4. **Informatë për manifestimin tradicional kulturo-sportiv "Flakadani i Karadakut" 2025.**
5. **Informatë për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Vitisë.**

Pasi që nuk ka për diskutim: a jeni që të miratohet rendi i ditës me ngritje dore? Me votat e të gjithve, miratohet rendi i ditës.

Si pikë e parë e rendit të ditës:

**1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e katër e kuvendit komunal**

**z.Bekim Azizi, kryesues:** Hapi debat. Pasi që nuk ka për debat: a jeni që të miratohet edhe kjo pikë? Me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim miratohet procesverbali.

Si pikë e dytë e rendit të ditës

**2.Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2024 në vitin 2025**

**znj.Milihate Ajeti, drejtroeshë:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2024 në vitin 2025 kryetari i komunës propozon kuvendit që ta aprovon propozim vendimi për të hyrat komunale të pa shpenzuar të vitit 2024. Propozimin e keni marr me kohë, për pyetje shtesë jemi në dispozicionin e juaj, mirëpo duhet me cek që e kemi një gabim teknik tek kodi, që kërkoj të përmirësohet, të cilin e dorëzova tek kryesuesi për përmirësim.

**z.Bekim Azizi, kryesues:** Hapi debat për këtë pikë të rendit të dites.

**z.Nexhat Haliti:** Tek propozim vendimi në fjalë, drejtoresha, vlera 230520.86 në fillim keni mos përputhje në mes të propozim vendimit për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2024 në vitin 2025, me pasqyrat financiare të vitit 2024, me datën 31.12.2024. Në propozim vendim janë 23520.86, ndërsa tek pasqyrat financiare

i ki 23320.95, dikun nja 200 euro i ki shtu. Se ka i keni marrë nuk po e di. Tash këto duhet me u përputh me pasqyrat. Tash e kam edhe nje vërejtje tek të hyrat vetanake të rritura, prej vitit 2023 në vitin 2024 janë bart 321 mijë e 272.43 euro, ndërsa prej 2024 në 2025 janë bart vlerën 230520, që do me thanë dikun nja 90 mijë euro është diferenca. Unë nuk po shof që ka pas rritje, unë po shof vetëm bartjen prej 2023 ne 2024, prej 2024 në 2025. Tash, shpërndarja e këtyre të hyrave, po ta potencoj edhe nja, aparati digjital me datën 13.06.2024 është parapa kur jan bart të hyrat vetanaka prej 2023 në 2024. Është parapa të blehet dhe janë parapa vlerat prej 3700 euro, ndërsa tash vlerën e ki 1870 uuro. Pse nuk është bë pagesa vitin e kaluar, po është leju me u marrë prej 2024 në 2025. Tjetra, tek kjo listë, blerja e aparateve që bartet prej vitit 2024-2025 nuk e ki, e ki vetëm tek arsyetimi. Qysh mundesh me ba arsyetim diçka, kur nuk e ke kërku. Tek mallrat dhe shërbimet, vlera 5063 euro, 863 euro janë Zyra e Kryetarit. Çka përfshihet tek Zyra e Kryetarit? Dhe shërbime shëndetësore primare 4200 euro. Çka përfshihen? Pse nuk janë shpenzu në vitin 2024 keto? Kategoria subvencione dhe transfere, Zyra e Kryetarit 4868.26. Çka përfshihet, a ka naj obligim ndaj bursave apo qka ka që mu bë kjo pagesë në tremujorin e parë dikun 9 mijë e diçka euro keni ba pagesa për subvencione dhe transfere në kuadër të kryetarit. Tek investimet kapitale, vlera 220589.56. Participimi i projekti me doatorë, shuma 100 mijë euro. Cilat projekte? Se keni mujt me i specifiku cilat projekte. Blerja e autoveturave, vlera 9640. Ju e keni parapa në buxhet vlerën 50 mijë, thash ju ka kushtu 59640 euro. Ju i keni ble tri vetura. A ban me ditë vetëm kur jan ble qeto tri vetura, në 2024 apo 2025? Nëse janë ble në 2024: pse nuk janë paraqitë si obligime në listën e obligimeve të vitit 2024? Kontrata për blerjen e veturave është përmes Agjensionit Qendror të Prokurimit, që vlera është 59640. Ju i keni në buxhet 50 mijë, kërkoni edhe 9640 euro. Rregullimi i rrethojave të shkollës "Bafti Haxhiu" dhe "Halil Alidema", edhe "Kuvendi i Lezhes" 4929.77. Unë po shof paqartësi financiare dhe obligimet e deklaruara në bazë të faturimit të vitit 2024, nuk shof që ka në list. Po me vjen qudi se ka po ju dalin këto, kur nuk e keni deklaru si obligim. Ndërtimi i tribunave në stadiumin në fshatin Skifteraj, 25 mijë euro. Ky projekt nuk ka kalu. Shuma e buxhetit ka qen 10 mijë euro. Procedurën e prokurimit kur e keni fillu është 35 mijë euro të planifikuara, plus tash kërkoni 25 mijë euro. Është projekt i vitit 2025, neni 9.7 i Ligjit të Buxhetit thotë decitivisht, duhet të kryhen obligimet e pa paguara të viti të kaluar ose vendimet gjyqësore të kotrates kolektive. Ndërtimi i fushave sportive, 50 mijë 981. A mundet me ditë pak, ku. cilët fusha janë? Renovimi i ambulantes, 11 mijë, e këtu këtë 11 mijë e kemi të deklaruar në listë. Kjo është në rregull. Riparimi i shkollave. Edhe kjo është 16 mijë. Në rregull, tash këto vetëm se edhe njëhere po e potencoj se, ligji thotë decitivish se, duhet të kryhen obligimet e pa paguara dhe vendimet e gjykatave për kontratra kolektive. Ju nuk e keni respektu.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Nexhat, ky është një propozim vendim, që ju cakton kodet, ndërsa ti qka po kërkon, duhet me ba nje raport në detaje, me të njoftu ty.

**z. Nexhat Haliti:** Unë thashë, obligimet e pa paguara që rrjedhin nga kontrata kolektive.

**znj.Milihate Ajeti, drejtroeshë:** Tek fotoaparati janë kanë mjetet e zotuara për vitin e kaluar, mirëpo kontrata kolektive, përmbaruesi i ka marrë paret dhe kemi mbet pa pare. E sa i përket tek Zyra e Kryetarit, e te shëndetësia, janë kanë të zotume vitin e kaluar, e tash duhet mi zotu në këtë vit.

**z.Nexhat Haliti:** Unë e kam këtë list. A ki ti listë tjetër?

**znj.Milihate Ajeti, drejtroeshë:** Ja u sjelli në seancën e radhës listën.

**znj.Majlinda Shabani:** Qekjo është një nga faktet dhe argomentet që tregon për planifikimin që e banë Komuna e Vitisë dhe për bartjen e mjeteve që naj bjen.

**z.Bekim Azizi, kryesues:** A jeni që të miratohet kjo pikë për bartejn e mjeteve? Kush është për? Kundër nuk ka, abstenim nuk ka. të gjithë janë pro.

Si pikë e tretë e rendit të ditës:

**3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për lirimin nga pagesa e punonjësve të Policisë së Kosovës, për shërbimet që afrohen në Qendrën e Mjekësisë Familjare dhe institucionet e tjera shëndetësore që menaxhohen nga Komuna e Vitisë**

Ne kemi diskutu, edhe është një kërkesë që është bë para tre muaj nga sindikata e policisë, që ju ka drejtu kryetarit dhe kryesuesit të kuvendit, që të lirohen nga pagesa në QKMF. E kemi pas një shkresë edhe prej zjarrfikësve, dhe në KPF kemi propozu nga të gjithë anëtarët që, kjo të futet në këtë propozim vendim, edhe e zjarrfikësve dhe punonjësve në FSK, sepse e dimë që në FSK e kemi një numër të vogël që punojnë nga Komuna e Vitisë, që të lirohen nga pagesa. D.m.th, në propozim vendim të hinë edhe zjarrfiksat edhe FSK-ja nga lirimi pagesave në QKMF. A ka për diskutim? Pasi që nuk ka: a jeni që të miratohet kjo pikë e rendit të ditës? Me të gjitha votat miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë e katër e rendit të ditës:

**4. Informatë për manifestimin tradicional kulturo-sportiv "Flakadani i Karadakut" 2025**

**z.Valmir Sahiti, drejtor:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Edhe këtë vit si çdo vit tjetër është mbajt manifestimi statutar tradicional kulturo-sportiv "Flakadani i Karadakut" në kuadër të cilit ka marr pjesë sportist, shkrimtar, artist dhe grupet sportive nga të gjitha trevat shqiptare. Dije se, ky manifestim mbahet për ta personifikuar veprën madhështore të komandat Njiazi Azemit "komandat mjekrra". Materialin e keni marr me kohë, për pyetjet shtesë jam në dispozicionin e juaj.

**z.Bekim Azizi, kryesues:** Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës.

**z.Jakup Demiri:** Tek faqja numër 9, tabela e shpenzimeve, këtu tek materiali që naj keni sjell, po shof akomodimi 580 euro, zgjerimi 755 euro, dreka, darka, shujta për grupet artistike dhe sportive 7170 euro, plus televizioni 1753 euro, shtypja, materiali grafik, 1980 euro. Gjithsej 12238 euro. Përveç këtyre darkave dhe drekave, që edhe e ka shumën më të madhe të shujtave: a janë sponzorizu me naj vlerë simbolike së paku qeto që kanë marrë pare, që kanë qenë në garë: a banë naj sqarim, se a janë shpërbly me naj sen.

**z.Ilir Zuka:** Drejtor, së pari ju përgëzoj për shumën e uljes së buxhetit. Po kam një lutje që, vitet e ardhshme të bëjnë pjesë 27 dëshmorë ose 28 sa janë, të jet një ditë taman të kushtohet ashtu siç duhet, se ne as sallën për seancë solemne për ditë të dëshmorëve nuk po muj me e mush. Kërkoj që vitet tjera të kushtohet një organizim shumë më i madh, shumë ditë më herët të fillohet, se 5 maji është dita e të gjithë dëshmorëve të Komunës së Vitisë. Nuk jam kundër "Flakadanit të Karadakut". Të përgëzoj për organizimin, për shumë që e keni zvoglu, po edhe një shqetësim tjetër edhe ju e keni pa. A e keni pa se sa njerëz marrin pjesë në këtë manifestim.

**z.Musli Neziri:** Drejtor, meqenëse po na shfaqet këtu shuma e kursyer ose e zbritur, çka ka ndiku që vitin e klaur me qenë një shifër më e madhe, e këtë vit me e vogël, përndryshe nga aspekti i manifestimit kulturor, "Flakadani Karadakut" dhe parafolësi Iliri që po thotë se për ditë të dëshmorëve kur të bëjmë thirrje për me përkrah me pjesëmarrje në aktivitete, sidomos në këto dita është mir që po kërkon Iliri, po diçka që me ka ra në sy mu, sa ne si këshilltar komunal marrim pjesë në këto aktivitete. Është për keqardhje gjendja e përfaqësuesve ose e këshilltarëve komunal që janë të zgjedhur dhe sa veta marrin pjesë. A keni pa naj here që mbahet dita 5 maj për dëshmorët e Komunës së Vitisë, ndërsa këshilltaret komunal pinë kafe, në kafe rrinë, dhe në shtëpinë e kulturës zhvillohet aktivitet për nderim të ditës së dëshmorëve. Ose më e frikshmja, ke 26 maji, prapë është e njëjta, dhe nëse i marrim i shofim në foto, takimet që janë mbajt, tubimet, qoftë për shpalljen e pavarësisë, 17 shkur, qoftë për 5 maj, ose për të gjithë dëshmorët, mundet ti një aktivitet në shtëpi të kulturës, dy ose tre këshilltar komunal. Kjo le të jet vërejtja edhe e imja, edhe për të gjithë ju, por mos të kërkojmë kur ne nuk jemi prezent me qenë e të kërkojmë nga qytetarët të paraqiten me mesovisht. Po ne duhet me ju përgjigj ftesës me aq sa mundemi.

**z.Taulant Haxhiu:** Përshëndetje të nderur të pranishëm! Drejtor, unë vij nga fusha e ekonomisë, dhe shpenzimet çdo kush që ka kësi shpenzime të manifestimeve jan rrit. Unë të përgëzoj që ti i ki 5453 euro, që ki arritë me i ulë shpenzimet në këtë mënyrë, është shumë kjo që i ki reduktu ti. Unë e përkrahi kolegun tonë Musli,

se kur po ka kësi festa, na e dimë rëndësinë e flakadanit, po është mirë të ketë më shumë njerëz. Edhe ne duhet me qenë prezent si këshilltar komunal. Po dua ta di, qeto darkat, shujtat 7170 euro, a hin edhe akomodimi në hotel, se disa vijn nga vendet e ndryshme të regjionit, dhe a është përfshi dhe akomodimi.

**z.Valmir Sahiti, drejtor:** Jakup, faleminderit për pyetje. Po, është e vërtet që ka pas çmime. P.sh.: tek ora e madhe letrare, çmimi "Flakadani i Karadakut" ka qenë 400 euro vendi i parë, vendi i dytë 200 euro, dhe mënyra se qysh e kemi zgjedh këtë çështje që dy vite, është tu ja kalu shoqatës së shkrimtarëve. Përgjegjësinë e organizimit të orës letrare, shoqata e shkrimtarëve ka apliku me projektu te subvencionet për "Flakadanin e Karadakut", dhe në këtë mënyrë kemi arritë edhe me i shperbly me të mirët. Rreth darkave dhe drekave, secilin këshilltar të kuvendit komunal, po edhe secilin qytatar të Vitisë e ftoj kur doni, faturat veç e veç për secilin natë mujn me i pa, është transparente, 8 euro për person është dreka dhe darka, bile shpeshher prej disa bizneseve e kam pas pytjen. Kështu pse po lufton kaq shumë për çmim, a mos buxheti i Komunës se Vitisë është i joti? Pytje dicitive. Po veç, tu ba, me njëfar mënyre tu tentu maksimum kemi arritë me i nxjerrë çmime që nuk janë çmime të tregut. 8 euro për person me pije nuk është çmim i tregut, e dini secili nga ju, prandaj unë po du me i falenderu edhe bizneset në veçanti të Vitisë, për transparencën, po edhe për koordinimin e tyre dhe ndihmen ndaj "Flakadanit të Karadaku". Ilir, është e vërtet se edhe dëshira e jemja është që 5 maji me qenë edhe me madhështor. Po ndoshta kjo ka të bëjë me vetdijen tonë qytetare dhe me atë se sa si popull dhe shoqëri e respektojmë të kaluarën, edhe sa i respektojmë vlerat. Musli, sa i përket uljes së shumës së "Flakadanit të Karadakut", po, p.sh.: për të kaluarën i kemi pas dikun 3000 euro vetëm te ndriçimi profesional, e për mos me pagu çdo vit nga 3000 euro, vitin e kaluar e kemi hap nje procedurë të prokurimit, e kemi ble ndriçimin tonë, e kemi në shtëpi të kulturës për çdo aktivitet, tani e kemi që ka kushtu hiç me shumë se 1100 euro, edhe kemi arritë Komunës së Vitisë për çdo vit me ja kursy me mijra euro. Tash me kursimet e "Flakadanit të Karadakut" e kemi në procedurë të tenderimit projektorin 3D të nivelit më të mirë, edhe besoj që shumë shpejt edhe kineman e qytetit me këtë kursim kemi me funksionu edhe ka me pas edhe filma per të rijt e qytetit të Vitisë. Te Taulanti, tek drekat dhe darkat. Taulant, akomodimi është në veti, se akomodimi është ulë çmimi për shkak se ansamblet nuk i kemi thirrë këtë vit dy a tri prej Shqipërsisë. Po i kemi thirrë dy. Njëri ka qendru për akomodim e njëri nuk ka qëndru, edhe kemi thirrë ansamble të Maqedonisë që nuk kanë nevojë për akomodim, dreka dhe darkat, i përfshinë drekat për shoqëritë kulturo-artistike, për klubet sportive që kanë marrë pjesë në gara për orën e madhe letrare, për garat e recitatorëve dhe për klubin e hajkingut. Duhet me pas parasysh që, manifestimi "Flakadani i Karadakut" nuk është festival siç janë disa festivale. Vetëm ta marr shembull nje festival "Hasi", që është shumë në përmasa me i vogël se "Flakadani i Karadakut", i ka pas 32 mijë euro në buxhet. Manifestimi i "Flakadanit të Karadakut", ngërthen në vete shumë aktivitete sportive, letrare, tu u përfshi dikun 1200 persona që participojnë në këtë aktivitet.

**z.Jakup Demiri:** Mirë që e ceke shpërblime, sepse nuk e disha këtë.

**z.Bekim Azizi, kryesues:** Faleminderit të gjithve! Kjo është informatë, nuk votohet. Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës.

Si pikë e pestë e rendit të ditës

**5. Informatë për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Vitisë**

**z.Basri Aliu, drejtori:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Sigurisht, matrialin e keni marrë me kohë, keni mund me shfletu. Unë po ju la hapësirë juve për pyetjet shtesë.

**z.Bekim Azizi, kryesues:** Unë du me ta ba një pyetje. P.sh.: i kemi 4157 ekonomi familjare që janë të kyqt në menaxhimin e mbeturinave. A ki bisedu, sa përqin i përfshinë pjesët e ekonomisë familjare, ose sa janë pa përfshi.

**z.Basri Aliu, drejtor:** Sipas "Ekohigjienes", po flas në bazë të të dhënave të tyre, që i kemi dikun 60 përçind janë të përfshirë. Po tash me regjistrimin që është bë kohën e fundit, mujmë ta nxjerrim një të dhënë me të sakt.

**z.Ilir Zuka:** Në disa seanca e kam pas ngrit, kemi pas kërku edhe një raport, p.sh.: në Pozharan ke familje, bënë kërkesë që të heket prej pagesës edhe e deklaron me 00. Si është e mundur ajo, se ai diku ka me i hudhë ato mbeturina. Këtë nuk duhet me leju, se ke në Pozheran, ki në shumë lagje që nuk paguajnë dhe kanë shku janë

terhek prej pagesës. Sa do unë e paguj, dhe vijnë e marrin, kur një afër meje nuk e pagun, edhe ai diku ka me i hudhë ato mbetuirna. Dhe kjo si është e mundur, si e ka leju "Ekohigjiena".

**z.Jakup Demiri:** Drejtor, diçka çka nuk ka funksionu. Shembull, ne nuk kemi një venddeponi për mbetje të ndryshme. Këto që po prishin e riparojnë shtëpi, e posaqërisht këto serviset, automekanikët, që është edhe me rrezikshmëri të lartë, ata i kemi krejt nëpër natyrë të shpërndamë pjesët e mbeturinave, dhe kjo është shqetësimi më i madh. Besoj që në secilin fshat kemi pjesë të metalta të automjeteve të cilët bartin vajra të ndryshme, që janë të rrezikshme për ambientin, dhe ne si kuvend komunal dhe ju si ekzekutiv nuk kemi punu në këtë drjetim, që të kemi një venddeponi për këto, ndërsa sa i përket kjo përqindja që delë rreth 40%, që nuk janë brenda sistemit, mua më duket që kjo shifër është më e madhe, por ndoshta që janë këta mërgimtarët që nuk janë në pagesë, dhe këta që janë prej socialit, por unë kam kqyrë në fshatin Smirë, delë ashtu që është diku 60-65% e fshatit e përfshimë në sistem të menaxhimit të mbeturinave të kuzhinës, e familjes, por jo edhe që janë këto kogjo problematike.

**z.Musli Neziri:** Drejtor, te kjo pjesa e mbulueshmërisë, se sa përqind mbulohet territori të ekonomitë familjare. Po, më intereson, duke pas parasysh edhe ngritje për vitin 2025 më pagesa, e që nuk u diskutu nga kolegët. A mos është kjo që në saj të asaj që nuk po mund me u mbulu, të gjithë me hy, na fakturojnë neve që jemi në sistem, d.m.th na rrisin çmimin për shkak të rritjes së tyre mi mbulu ata që nuk hynë. D.m.th, ata edhe nuk hinë në sistem të mbeturinave, edhe ngritet çmimi i tyre që janë në sistem, për shkak mbulueshmërisë prej qendrës. Po e kem kështu për shkak që s'po mund diku një humbje, dikush duhet me pagu. Të njëjtën gjendje po na fakturojnë këto tjerat, bashkësitë fetare, në saj të asaj që nuk po mundemi me i shti krejt, i ngrisim çmimet. Unë mendoj që, duhet me u detyru sistemi i mbeturinave për qytetarët, duhet me gjetë një modalitet. Ne e dimë që ka qenë kundër ligjore më herët, ka qenë me regjistrim të automjeteve. Po e themë këtë, se përderisa nuk jemi të gjithë të përfshirë, nuk ndalet kjo hudhje e mbeturinave vend e pa vend. P.sh.: nëse dalim i kqyrim rrugët, nuk po flasim për fshatra, por vetëm rrugës Sllatinës, rrugës ka Pozherani, rrugës Drobeshit, të njëjtën gjendje. Të gjithë ne po e dimë që, në muajin prill po e kemi angazhimin që me pastru, e intervenohet nga komuna. Disa vende prapë vitin tjetër njëjtë, por unë mendoj që duhet me gjetë një modalitet me i detyru të gjithë, sepse tek e fundit ai që thotë unë nuk hy, ai diku ka me gjujtë. Në ta pagun e mos ta qetë bërllogun hiç te dera, duhet me gjetë një metod, nuk ka ndryshe, nuk vetdijësohet shoqëria ndryshe. E vetmja mekanizëm me vetëdijësu shoqërinë është te pagesa ose te gjobat kur ja japin në trafik policia, ndryshe nuk ndalet populli. Kjo është në krejt botën, prandaj këtu nuk duhet me bë tolerim. Nuk është në rregull kjo, në saje të asaj, për shkak të ngritjes së çmimeve, rritja çmimin këtyre 50-60% e ata të tjerët prapë rrijnë njëjtë. D.m.th paguajmë ne të tjerët për ta, dhe përmirësim nuk po kemi. Dhe të shërbimet tjera ndodhë që kompania e thenë kontinierin dhe ta bjen kontinierin dhe të thotë, paguaje që po e merrë tjeterin.

**znj.Majlinda Shabani:** Po mundohem me u ndërlidh në çështjen e mbeturinave në Komunën e Vitisë, sepse e dimë që është një problematikë shumë e madhe, dhe e dimë që tash sa kohë faktikisht edhe ne si opozitë e kritikojmë, d.m.th se qysh komuna ka dështu për me bë një menaxhim sistematik të mbeturinave. Mua realisht më ka interesu ky raport i menaxhimit të mbeturinava që bëhet në Komunë të Vitisë, dhe me pa prej anës së kompanisë, se sa ka kapacitete për me i përmbush nevojat që qytetarët e Komunës së Vitisë kanë nevojë për këto shërbime, dhe mandej me pa dhe anën e komunës, se sa ka gatishmëri, dhe çka planifikon për zgjidhjen e kësaj problematike. Në atë të asaj çka unë po e shofë, e para është se, kam disa pika që dua me i diskutu, por e para është tek numri i kamionëve që qenkan, në dispozicion janë 4 kamion dhe nuk e di se sa janë të mjatueshme për me i përmbush këto kërkesa. Në anën tjetër po flasim dhe për qytetarët të cilët nuk kanë qasje në sistem. Tash me ja bë pyetjen vetes, në rastë se qasja në sitemin e shërbimeve për mbeturina kishte me qenë shumë më i lartë, sa kish me pas kapacitet kompania private me i përmbush këto kërkesa dhe nevoja. Ne e dimë, sidomos gjatë veres kur vijnë mërgimtarët, se sa grumbullohen mbeturinat dhe sa qëndrojnë me ditë. Kam pas raste, në fshatin Lubishtë, ku kam ngirtë si shqetësim dhe kërkesë, që ka ndodh me javë që nuk kanë ardhë me marrë mbeturinat, në anën tjetër po i shofë kamionat. Tash nuk e di se sa këto kamiona, veç në bazë të vitit këto veç janë zhvlerësu. Mendoj që dhe kjo është njëra prej çështjeve që duhet me adresu. Në anën tjetër më intereson me ditë drejtor,

sepse unë e kuptoj që në një anë është edhe fakti i ndergjegjësimit dhe edukimit, se sa komuna punon në këtë drejtim dhe sa investon, por në anën tjetër a keni mëndu se çfarë mekanizma duhet me përdor, që të gjithë qytetarët e Komunës së Vitisë me pas qasje. Tash përpos rregulloreve që duhet me kthy një vëmendje, dhe me punu në rregullore, duhet me punu edhe me çështjen e inspektimit. Tash unë po bëjë pyetje konkrete: a kemi ndonjë rast që, filan fisteku ka hudhë mbeturian diku, dhe është inspektu, dhe ka marrë gjobë për këtë, sepse pikërisht është kjo çështja që gjithsecili qytetarë, në moment që nuk shqiptohet një gjobë ose nuk shtrohet kjo kontrolla prej anës së komunës, vazhdon mendësia e njëjtë për sa i përket mbeturinave. Mua më intereson me ditë për disa adresime pak më afatgjate. Përpos anës së komunës që duhet me shtu më shumë buxhet në menaxhim të mbeturinave dhe duhet me mëndu dhe këtë menaxhimin sistematik por dhe duhet me mëndu faktin dmth zgjidhjen me partniritete qoftë donacione shoqatave organizata të huaja nderkombtare që realisht jan shumë të irneresume për politika të gjelberta që kishum mujtë me inkuardu në komunë të Vitisë, e dimë që komuna e Vitisë ëhst ëkomunë shumë e vogël e dimë që kish mujtë me qenë shembull sa i përket menaxhimit të mbeturinave andaj mua më intereson me ditë se sa është marrë komuna e Vitisë me kete problamtik tu mos ja hudhë komplet fajin kompanis private që e bënë grumbullimin e mbeturinave.

**znj.Liridona Bislimi:** Një çështje që më intereson, përpos këtyre problematikave që u permenden, një çështje që më shqetëson, por po besoj që është një problematikë shumë e madhe. Ne hasim shumë here në mbeturina inerte, por dhe mbeturina tjera më të madha, me të cilën qytetarët nuk dinë me vepru për këtë, por jo vetëm qytetarët, ne kemi pas raste të ngjashme, ku ju si institucion komunal i keni vendos mbeturinat në vende të cilat as nuk është dashtë me mëndu me i vendos aty. Kemi pas rastin konkret para disa viteve, ku keni vendos në lumin "Morava" mbeturina shumë të mëdha, të cilat kanë bë pengesë shumë të madhe. Pastaj kemi pas rastin e shkollës në Sllatinë, ku është bërë renovimi i shkollës. Po ato mbeturina e keni vendos në malin "Mllak", në atë pjesë ku ka qenë gjelbrim. E po më intereson qekjo çështje: a e keni bisedu këtë çështje, a është vendos diçka për me bë? Për shkak se, deri tash e din që u thanë janë disa vende të përcaktume. Edhe kjo pjesë e "Ekohigjienes" a është bisedu me ta konkretisht për me i njoftu qytetarët për shkak se kjo pjesë është një farë neglishence, sepse unë për veti e di, në fshatin Drobesh, tek pjesa tjetër e fshatit, vazhdimisht ka mbeturina, te ajo pjesa që shkon për tek fshati Smirë, që e lidhë me Drobeshin. Unë e di që disa here i keni marr disa hapa konkret, disa aksione, mirëpo të nesrit apo të masnesrit, prapë kur kemi shku në të njëjtin vend ka qenë gjendja e njëjtë. E për këtë na po kërkojmë këtë pikë, sepse kemi ditë me ditë ndoshta edhe për gjobat të cilat janë vendos, edhe për të cilat janë ndërmarr direkt për qytetarët, sepse ju keni thanë që, qytetarët po i hudhin mbeturinat, po unë këtu nuk pash rast specifik se çka keni ndërmarr ju. Unë kam pritë që, kemi me pas edhe ndonjë përfaqësues të kompanisë që me bisedu edhe me gjerësisht me këtë, mirëpo kjo çështja e mbeturinave inerte, ku gabimet i bëjnë qytetarët, po edhe ju keni bë si institucion. Edhe tek gjobat ka qenë më mirë me pas informacione që, edhe një me i njoftu qytetarët, se ka gjoba, bile kishte me qenë mirë me u bë edhe publike gjobat, për me ndiku në vetdijësim.

**z.Reshat Azizi:** Përshëndetje për të gjithë! Mos ti përsëriti atë çka u tha nga parafolësi, po është shqetësuese numrimi i ekonomive familjare, vetëm 4167 ekonomi familjare që janë të përfshime në proqesin e mbeturinave. Po e kam edhe një shqetësim tjetër. Këto shkresat që po na vijnë në kuvend, shumë bre me gabime. Me të vërtet është turp me pa vetëm titullin se qysh vjen. Informatë për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Vitisë. A i kontrollon najkush këto kur të vijnë, e qysh vijnë? Organi më i lartë në komunë me na ardh me kësi tekste. Me të vërtet është për keqardhje. Plus gabime teknike. Unë po e shof, thotë: Stublla e Poshtme, 63 ekonomi familjare. Unë nuk e di që i ka 63 persona e le ma ekonomi familjare. A mos kanë dashtë me shkru Stublla e Epërme. Së paku le të këshyren këto, se ka gabime teknike e drejtshkrimore.

**z.Bekim Azizi, kryesues**: Zyra e Kuvendit i procedon ashtu siç i bjen drejtoria, ashtu siç naj sjellin neve. Ne i procedojmë. Unë mendoj që duhet me bë thirrje që mu përfshi të gjithë në grumbullimin e mbeturinave.

**z.Basri Sylejmani:** Këto mbeturina shumica janë nga ndërtimtarët, e ti kemi syt të hapur, që le të dënohen disa ndërtimtar që qesin mbeturina, sepse me kamjona i qojnë në Goshicë, e rrugës për në Smirë. Ata duhet me i denu ndërtimtarët, sepse ata po i qesin. Unë p.sh.: në Sadovinë nuk ka shumë, ama jasht Sadovines ka shumë për nga regjioni i jonë.

**z.Basri Aliu, drejtor:** Edhe unë jam dakort me disa shqetësime, sepse është një çështje jo vetëm në komunën tonë, po në të gjithë Republikën e Kosovës. Nëse bëjmë krahasimin, ne jemi më mirë se disa të tjera, po nuk do të thotë që ne duhet me qenë të knaqur me këtë gjendje të cilën e kemi. Reshati i pat disa vërejtje, kjo është informatë e "Ekohigjienes", që e ka bë. Mundet me pas gabime teknike e gjuhësore. Vendpunishtet për hedhjen e mbeturinave, dikun në legjislacionin 2011-2012 kuvendi ka vendos për tri lokacione që mundet të hudhen mbeturinat e ngurta. Një ka qenë në mes të Devajes dhe Radivojcit, tjetra afër Trestenikut, dhe pjesa tjetër ka qenë këtu në hyrje, te Kalaja e Binçës. Rrethojat janë ba për qato vende që janë përcaktu nga ky kuvend për hudhjen e mbeturinave inerte. Në mbeturinat inerte në Devajë dhe Radivojcë, gjatë jave që shkoj vetëm e kemi eleminu, sepse dul edhe jash konturave të saj. D.m.th kemi intervenu, e tani nuk do të lejojmë me hedh aty mbeturina ma. Unë e kam bë një kërkesë në agjencionin e pylltarisë për atë gropën që është afër Budrikës, që të na lejon ti hedhim mbeturinat inerte, që ta mbushim atë, sepse edhe paraqet rrezikshmëri ajo, edhe për qytetarët e për bagti që kullosin aty, dhe në fund që ne ta kthejmë në vend të gjelbër, kur te përfundi ende nuk e kam marrë përgjigjen nga agjensia, po sigurisht që edhe me hartat zonale që do të bëhen ndoshta parashihet edhe se ku do të vendosen mbeturina inerte. Ne në bashkëpunim me GIZ-in që e keni pas planin e menaxhimit të mbeturinave, dy vite një ekip i komunës ka qenë edhe në ato punëtori që kanë ardh në përfundim, se si bëhet plani i menaxhimit të mbeturinave, së bashku me investitorë, e tjerë. Atë plan e keni pas këtu, po presim edhe ligjshmërinë e atij plani dhe të shofim se si do të menaxhohet në të gjithë rajonin. "Ekohigjiena" nuk e ka grumbullimin e mbeturinave inerte, ata e kanë menaxhimin e mbeturinave të tjera. Sa i përket mos futjes së të gjitha ekonomive familjare, është mos përgjegjësi e qytetarëve, duhet të futen të gjithë aty. Ne instrument për futjen e tyre në sistem e kemi telashe, sepse infrastrukturë ligjore nuk lejon me e fut dikan, po ata duhet të shkojnë të bëjnë kontratë me "Ekohigjienen" në mënyrë që atje të shkon edhe "Ekohigjiena" t'i merr mbeturinat. A ka mjaft kamion për me i terjek mbeturinat, ata e kanë planifiku, se si kompani kanë mjaft për këtë që paguaj. Realisht na edhe indirekt disa vetëm jemi tu i pagu, që ata nuk janë kyç, sepse po vijnë po naj hudhin në qytet, e ne po jem ata që po duhet me i largu, dhe ata nuk jan fut hiq në sistem. Me një farë forme indirekte është tu marr një pjesë, po ndoshta po i gjuan dikun në natyrë, se sa me pagu një pagesë prej 6 euro apo sa i ka Ekohigjoena. Unë ju kam lut, edhe prapë po ju lus se, kushdo që është aty në mesin e vet, kontakt me qytetar, ndikoni që le të hinë në sistem të mbeturinave. Mund të ndodhë që, kemi edhe zyrtar që nuk janë të futur në sistem të mbeturinave. Mund të ndodhë edhe këtu në mesin tonë që jemi. A ka ba komuna diçka tjetër rreth menaxhimit të mbeturinave. Po, kemi ba. Komuna me grand të përformances, faktikisht i ka sjell disa kontenjer, të cilët ja ka dhanë Ekohigjienes, në mënyrë që ata i kanë shpërnda ata kontenjer tek qytetarët. Ne edhe frik e patëm një puntori me Komunën e Kiharnit dhe me institucion tjetër për mbeturinat organike, tu e shqyrtu një projekt për me u bë në Komunën e Vitisë. Jemi tu marr me këtë çështje. A jemi të knaqur me rezultatet në teren, nuk jemi. Po apeli i jem është se, duhet mundohemi secili që aty ku kemi mundësi me ndiku. Qe një shembull po ju tregoj. Dikun 10 mijë euro po na kushton hekja e mbeturinave në Devajë. D.m.th edhe në buxhet po na kushton kjo. U përmend edhe çmimi, e çmimi realisht me kuvend nuk ka kalu këtu tek ne, e ata e kan ngritë në bazë të ngritjes së derivateve dhe deponimeve që i qojnë Ekohigjiena atje, që ministria e ka ba, dhe bordi i Ekohigjienes e ka parapa që, çmimi që është për momentin. Sa i përket dënimeve, ka pas disa dënime, po i ka bë Drejtoria e Inspeksionit, e ka raportin, kështu që ka ndodh që janë dënu personat që i kanë hedhë.

**z.Sejdi Emini:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Krejt diskutimet që u banë, me lanë pak hapësirë me mendu, që nuk u banën me ba zgjidhje, po vetëm me ba më shumë politikë, me ba temë se sa me kry punë. A keni me ardhë me e hek deponitë e egra që janë në Goshicë konkret, që mos t'i përmendi që ka mjaft shumë, a po me jav lanë banorëve, e banorët me u marrë me atë punë. Qato mbeturina janë ka e shëmtojnë një natyrë që është e mrekullueshme. Qysh i keni hek në Devajë pas reagimit që e kemi pas në seancën e kalume. E mirë që ishin hek, është mirë me ardh me e hek edhe ata atje, ose kërkone ndihmen edhe të banorëve, e besoj me plotë kuptimin e fjalës që, kemi me qenë të gatshëm me ju nimu edhe na ti hekmi, se janë keq. Edhe nëse i hekmi, Drejtoria e Inspeksionit nëse nuk merr hapa me i dënu ata të cilët i hudhin mbeturinat, unë po mendoj që kot jemi tu punu. A banë me ditЍ se sa gjoba bre i keni ba për krejt qeto mbeturina që po diskutojmë qekaq shumë?

Sa gjoba janë shqiptur prej Komunës së Vitisë për keqbërësit e natyrës? Ta dimë edhe na si kuvend. Edhe një pyetje. Kompania Ekohigjiena deri kur e ka kontratën, kur i skadon afati, që me ditë që kur të merret një kompani me u merr një kompani me serioze, pak që taman e kryen punën si duhet me e kry.

**z.Basri Aliu, drejtori:** Sejdë, u kyçe me vonesë, se shumicën e tyre u ceken. A ka mundësi banorët. Po more, banorët janë ata që mujn me e ndalu këtë punë. Këta janë kryesorët që mundet me e ndalu këtë punë. Goshica i ka dikun 250 shtëpi, a 81 familje janë të inkuadruar në sistem të mbeturinave. Unë po thamë që, banorët le të kyqen në sistemin e mbeturinave dhe le t'i pengojnë të tjerët të cilët hudhin. Po edhe ju i hasni ata, po nuk jeni në gjendje me ardhe me tregu.

**z.Bekim Azizi, kryesues:** Faleminderit drejtorm faleminderit nga të gjithë për kontributin e dhënë në këtë seancë. Mirë u pafshmi në seancën e radhës!

Mbledhja përfundoi me punë në ora 12:00 min.

**Procesmbajtësi:**
**Fatlum Demiri**

______________________

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal:**
**Bekim Azizi**

______________________

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA

| Pranuar-Primljeno më 11.06.2025 | | | |
|---|---|---|---|
| Nr. i organit Org. Broj | Numri Broj | Shtojce Prilog | Vlera Vrednost |
| 02-035/02 | -6 | | 10 |

Republika e Kosovës — Komuna e Vitisë

Bazuar në nenin 58 shkronja h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 të Kuvendit të Republikës së Kosovës ( Gazeta zyrtare nr 28/2008), dhe nenit 50 shkronja I) të Statutit të Komunës së Vitisë me numër 013/491 të datës 21.04.2011 , Kryetari i Komunës së Vitisë paraqet këtë :

## PROPOZIM VENDIM
## PËR KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE ( KAB ) TË KOMUNËS SË VITISË 2026-2028

**Neni 1**

Kryetari i Komunës së Vitisë i propozon Kuvendit Komunal që të aprovoj Vendimin „ KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE ( KAB ) E KOMUNËS SË VITISË 2026-2028 "

Duke u bazuar në QARKOREN Buxhetore 2026/01 të datës 15.05.2025 nga Ministria e Financave Punës dhe Treansfereve ku paraqet bazën për hartimin e buxhetit për vitin 2026-2028.

**Neni 2**

Pjesë përbërëse e këtij propozim vendimi është „KORNIZA AFATMESME BUXHETORE ( KAB ) E KOMUNËS SË VITISË 2026-2028 " e hartuar nga Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim .

**Neni 3**

Për zbatimin e këtij propozim vendimi do të kujdeset Kryetari dhe Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim e Komunës së Vitisë.

**Neni 4**

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë dhe e nënshkrimit nga ana e kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Vitisë.

PROPOZUES : KRYETARI I KOMUNËS
Sokol Haliti

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova - Republic of Kosova

# KORNIZA AFATMESME BUXHETORE (KAB) E KOMUNËS SË VITISË 2026-2028

**Drejtoria për Financa Ekonomi dhe Zhvillim**

**2025**

# Përmbajtja

I. Hyrje

II. Deklarata e Komunës në lidhje me prioritetet strategjike zhvillimore

III. Korniza Fiskale

3.1 Korniza makroekonomike komunale
3.2 Tendenca e të hyrave komunale dhe parashikimet 2026-2028
3.3 Politikat e reja
3.4 Tendenca e shpenzimeve komunale dhe parashikimet 2026-2028

IV Korniza e Shpenzimeve

# I. Hyrje

Korniza Afatmesme Buxhetore, KAB, është një dokument i cili përgatitet nga zyrtarët e administratës komunale dhe miratohet në parim çdo vit nga Asambleja Komunale. Ky material siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor. Gjithashtu, KAB, siguron mekanizmat e nevojshëm, përmes të cilëve, objektivat prioritare të identifikuara në dokumentet strategjike të komunës, aty ku ekzistojnë, të integrohen sa më mirë në procesin buxhetor.

Hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore përbën një detyrim për institucionet buxhetore komunale të kërkuar nga Qarkoret Buxhetore Komunale 2026/01 të lëshuar nga Ministria e Financave ,Punës dhe Transfereve .

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2026-2028 (KAB 2026-2028) paraqet dokumentin kryesor mbi bazën e të cilit do të hartohet Buxheti Vjetor për vitin 2026. Qëllimi kryesor i KASH-it është që të ofrojë një analizë të bazuar për të vendosur kështu bazën për planifikimet buxhetore për vitet që vijnë në përputhje me prioritetet strategjike të Qeverisë.

Korniza Afatmesme Buxhetore do të jetë baza për përcaktimin e sektorëve prioritarë të zhvillimit dhe identifikimin e prioriteteve të shpërndarjes së drejtë të burimeve komunale për periudhën 2026-2028. Janë katër faza të përmbledhura për zhvillimin e KAB Komunale dhe afatet kohore, si në figurën e mëposhtëme:

## II. Deklarata e Komunës në lidhje me prioritetet strategjike zhvillimore

Komuna e Vitisë shtrihet në pjesën Juglindore të Kosovës, rajoni i Anamoravës, përafërsisht 40 km në jug të Prishtinës. Kufizohet me pesë (5) komuna tjera (Gjilanin, Ferizajn, Kaçanikun Kllokotin e Parteshin dhe në jug me Republikën e Maqedonisë. Pozita gjeografike që ka i mundëson asaj lidhje të mira me qendrat tjera të Kosovës dhe të rajonit. Lumi "Morava" e Binçës kalon përmes luginës qendrore të komunës, ku krijon kushte më të favorshme për aktivitete bujqësore. Vitia i takon zonës me klimë të mesme kontinentale, ku lartësia mbidetare nuk i kalon mbi 1400 metra.

Komuna e Vitisë ka gjithsej 39 vendbanime. Prej tyre janë 38 fshatra dhe qyteti i Vitisë. Sipas rezultateve preliminare të regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, Komuna e Vitisë ka 46,951 banorë rezidentë dhe 13604 banorë jashtë Kosovës, të organizuar në 7519 ekonomi familjare. 69% nga popullsia del se janë mbi moshën 15 vjeçare. Nga viti 2011 deri ne vitin 2019 popullsia e Komunës së Vitisë ka tendenca të rritjes. Sipas përkatësisë gjinore, përbërja meshkuj femra është 49.60% femra dhe 50.40% meshkuj. Në raport të popullsisë qendër dhe pjesëve rurale, përqindja e popullsisë që jetojnë në qytet sillet rreth 10% dhe 90% në pjesët rurale (fshatra).

Sipas përbërjes etnike, popullsia në Komunën e Vitisë ka këtë statistikë: gjithsej janë 99.3% janë shqiptar, ndërsa minoritetet tjera janë serb me 113 serb, 25 boshnjak, 14 ashkali, 12 rom, 7 goran, 4 turq dhe të tjerë janë 143 banor, që në përqindje i bie 0.7 % minoritete tjera jo shqiptare.

Migrimi i popullsisë vitiase është përshkruar me trend të rritjes si nga brenda ashtu edhe nga jashtë shtetit. Sot konsiderohet se përqindja e migrimit të jashtëm të popullsisë është 13180 banorë apo 28% e numrit të përgjithshëm të banorëve, që jetojnë, veprojnë e punojnë jashtë Kosovës, ndërsa migrimi i brendshëm është i theksuar.

Sa i përket moshës së popullsisë, kryesisht dominon mosha 0 - 19 vjeç, apo në përqindje 41.10%; mosha 20 - 64 vjet, apo 52.50%; dhe mosha mbi 65 vjeç, 6.40%.( sipas regjistrimit të popullsisi së vitit 2011 , ende nuk kemi mundur ti gjenerojmë të dhënat e rejistrimit të vititi 2024)

Në aspektin gjeografik Vitia është e vendosur në rrugën rajonale që lidhë Gjilanin dhe Ferizajn, ndërsa lumi "Morava" kalon nëpër komunë, duke krijuar kushte të mira për bujqësi.

## Komuna e Vitisë



Vizioni i mëposhtëm për Komunën e Vitisë i definuar pas konsultimeve me akterët e rëndësishëm të jetës politike ekonomike e sociale në Komunë bazohet edhe në dokumentet afatmesme dhe afatgjata strategjike, që ka zhvilluar komuna sic janë:

1. **Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2026-2028 të Qeverisë së Kosovës dhe prioriteteve bazë të saj, si dhe Qarkoret Buxhetore Komunale 2026/01 të lëshuar nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve të Qeverisë së Republikës së Kosovës.**
2. **Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal 2022 - 2026**
3. **Plani zhvillimor Komunal 2023-2031**

**Vizioni i Komunës për tri vitet e ardhshme është një vend me plan të zhvilluar komunal dhe urban, zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, dhe shërbime efikase e kualitative, i integruar në proceset rajonale dhe ndërkombëtare, si një qendër me kultura bujqësore , industri përpunuese ( drurit, metaleve ), e kulturës së pasur, arsimimit dhe jetës sportive, me shërbime financiare të zhvilluara dhe krijimit të kushteve më të mira të jetesës për të gjithë qytetarët e saj pa dallime në baza gjinore** ***për të gjithë qytetarët e saj (gra, burra, vajza dhe djem), ose promovimin e barazise gjinore .***

***Djep kulturor i shkollës shqipe, urë e zhvillimit të qëndrueshëm, modern, të fuqishëm, funksional me të gjitha përmbajtjet, komunë policentrike, atraktive për të jetuar dhe punuar, partneritetet publiko private do të determinojnë shërbimet cilësore, aktivitete ekonomike tregtare, industriale dhe turizëm në zhvillim,Komuna e Vitisë do jetë me të gjitha resurset atraktive për investime dhe ndërmarrësi,sidomos në industrinë përpunuese, agrobiznes, turizëm kulturor e rekreativ, me theks të veçantë në zhvillimin e qëndrueshëm, modern, të fuqishëm, funksional me të gjitha përmbajtjet, qytet kompaktë, atraktiv për të jetuar dhe punuar, promovues i partneritetet publiko private me shërbime cilësore, aktivitete ekonomike e mirëqenie në zhvillim, me rolin dhe identitetin e fuqizuar.***

Atributet më të rëndësishme të çfarëdo dokumenti të planifikimit strategjik dhe vizionit të definuar janë së pari lehtësira e komunikimit si dhe së dyti llogaridhënia. Me qëllim të përmbushjes së këtyre dy atributeve binjake prioritet strategjike të Komunës në periudhën afatmesme janë grupuar në pesë prioritete që do të mundësojnë realizimin e qëllimit të vizionit tonë për Komunën.

Nga këto pesë prioritete kanë të bëjnë me realizimin e objektivave dhe kontribuon në zhvillimin e shërbimeve më të mira komunale për qytetarët e Komunës së Vitisë:

**1. Forcimi i Ekonomisë Komunale me mundësi për të gjithë (me prioritet fuqizimin ekonomik të grave)**

Rritja e ekonomisë komunale përmes:

- Përmirësimit të standardeve të arsimimit dhe nivelit të arritjes (pajisje shkollore, renovime shkollore dhe permirësim, bursa për student/e, laboratore)
- Mbështetjes direkte të sektorit bujqësor dhe blegtorisë
- Krijimit të lehtësirave për hapjen e bizneseve të reja për gratë ndërmarrëse dhe subvensionimi në bizneset ekzistuese

## 2. Përmirësimi i shëndetësisë dhe mirëqenies së qytetarëve (gra/vajza, burra/djem)

Krijimi dhe ndihma për qytetarët (gra/vajza, burra/djem) për të pasur jetë të shëndetshme dhe aktive në komunitetin e tyre:

- Ndihmat momentale për familjet në nevojë
- Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore, ofrimi i shëndetësisë mobile (Caritas Kosova)
- Të sigurohet qasje në shërbimet riprodhuese të kujdesit shëndetësor duke përfshir planifikimin familjar, informimin dhe edukimin si dhe integrimin e shëndetit riprodhues

## 3. Përmirësimi i ambientit të Komunës dhe qëndrueshmëria e tij

Absorbimi i popullatës së komunës dhe njëkohësisht mbrojtja e ambientit përmes:

- Përmirësimit dhe rigjenerimit të infrastrukturës rrugore (shenjëzimi i komunikacionit, ndriqimi publik dhe numerizimi), transportit, kanalizimit dhe ujit të pijshëm ,
- Përmirësimit të standardeve ambientale, për një ambient të pastër dhe të sigurt për të gjithë qytetarët pa dallim gjinie
- Ofrimi i më shumë hapësirave dekorative , parqeve rekreative qw shwrbejnw pwr tw gjithw qytetarwt pa dallim gjinie dhe moshe
- Promovimi i projekteve për rini , sport dhe kulturë duke i inkurajuar vajzat e reja që të jen pjesë active në sport dhe kulturë

## 4. Krijimi i sigurisë për qytetarët e komunës

- Përmirësimi i sigurisë në qytet dhe në tërë teritorin e komunës, ofrimit të kushteve që garantojn sigurin qytetare përmes rregullimit të sinjalistikës rrugore, ndërtimit të trotuareve, rregullimit të ndriqimit publik, etj

Ndërsa prioriteti i fundit strategjik i Komunës ka të bëjë me efikasitetin e brendshëm të qeverisë komunale dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve për qytetarët e saj (gra/vajza, burra/djem).

## 5. Funksionalizimi i qeverisjes komunale që ofron shërbime efikase dhe që u përgjigjet kërkesave të qytetarëve pa dallime duke zbatuar Parimin e Mosdiskriminimit

Përmirësimi i shërbimeve komunale për ballë qytetarëve duke u fokusuar në qasjen më të lehtë të tyre në administratë

5 (pesë) fushat prioritare të komunës dhe objektivat e saj për periudhën afatmesme 2026-2028 do të shoqërohen me të hyra dhe shpenzime në të pesë kategoritë ekonomike, të cilat do të mund të monitorohen dhe raportohen karshi arritjeve përmes raporteve financiare tremujore .

**Historiku i shkurtër komunës së Vitisë në fushat :**

**Zhvillimi Ekonomik**

Vitia, nëpër të cilën kalon lumi Morava e Binçës, shtrihet në pjesën qendrore të fushë gropës së Moravës së Epërme. Lumi Morava e Binçës, në të cilën derdhet edhe lumi Letnica, ka një rëndësi të madhe ekonomike, meqë mundëson ujitjen e tokave. E vendosur në një rrafshinë shumë pjellore, ka mundësinë e kultivimit të të gjitha bimëve bujqësore. Kjo është edhe arsyeja që sektori i bujqësisë është njëri ndër sektorët kryesor të zhvillimit ekonomik të komunës së Vitisë, edhe pse viteve të pasluftës ka ngelur prapa në këtë drejtim, për të krijuar një përparësi tregtia dhe më pak zejtaria.
Sidoqoftë, Komuna e Vitisë ka potencial të madh të zhvillimit të sektorit bujqësor.

Përparësitë e komunës së Vitisë për zhvillimin e bujqësisë janë:

- Numri i madh i fermerëve burra/gra, vajza/djem dhe tradita në bujqësi
- Kualiteti i mirë i tokës bujqësore
- Rendimentet e mira në perimtari
- Ekspert të mjaftueshëm të sektorit bujqësor etj...

Duke pasur parasysh zhvillimin e bujqësisë në të ardhmen në komunën e Vitisë është hartuar një strategji për zhvillimin bujqësor që në vete ngërthen:

- Përmirësimi i infrastrukturës rrugore- rurale
- Projektet për ngritjen e kapaciteteve përpunuese
- Ndërrimi i metodologjisë në kultivimin e kulturave lavërtare ( grurit dhe misrit)
- Rritja e kapaciteteve të fermave ( kalimi i tyre nga fermat e vogla në ferma të mesme dhe të mëdha)
- Hapja e punkteve grumbulluese për grumbullimin e prodhimeve bujqësore (mënyrë e vetme për bujqit, për ti shitur në mënyrë të sigurt prodhimet e tyre në treg).
- Ngritja e fabrikave për përpunimin e prodhimeve bujqësore duke pwrfshirw fabrika qw udhwheqen nga gratw/vajzat dhe burrat/djemtw
- Zhvillimi më i madh i viseve rurale në bujqësi ( ngritja e plantacioneve të pemëve)
- Ngritja e kapacitete për zhvillimin e agro-turizmit në komunën e Vitisë, duke trajnuar fermer/e
- Projektet për zhvillimin e bujqësisë organike ( nevojë dhe perspektivë e kohës)
- Menaxhimi dhe shfrytëzimi i drejtë i pyjeve, dhe
- Angazhimi i ekspertëve bujqësorë në aktivitetet e bujqësisë etj...
- Të shtohen politika që përfshijnë përspektivën gjinore.

**Arsimi**

Procesi edukativo arsimor në Komunën e Vitisë përfshinë nivelet e ndryshme si prej atij parafillor e deri te ai i mesëm e i lartë. Mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe dhe në atë serbe dhe ka gjithsej 17 shkolla fillore me 18 paralele të ndara fizike në gjuhën shqipe dhe 3 shkolla të mesme. Gjithashtu në këtë komunë procesin mësimor e zhvillojnë edhe 1 shkollë fillore në gjuhën serbe , dhe arsimi parashkollor- çerdhja "Gëzimi ynë " në Viti dhe qerdhja në fshatin Qifllak.
Në këto institucione shkollore do të vijojnë mësimin në vitin 2026 6,812 nxënës (7,026 në vitin 2025 çka do të thotë se kemi 214 nxënës më pak se në vitin 2025 shih Qarkoren Buxhetore 2026/01 ................. ( të vendosen numri i nxënësve në baza gjinore)
Më qellim të ofrimit sa më të mirë të kushteve në fushën e arsimit të kësaj komune për punë dhe për zhvillimin e procesit edukativo mësimor dhe të ngritjes së cilësisë së saj, në agjendën e Institucioneve komunale është jo vetëm përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese shkollore, por edhe ndërtimi i shkollave të reja , komuna planifikon të mbështes :

- *Rritja e përfshirjes së fëmijëve në institucionet parashkollore,*
- *Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies në arsimin fillor dhe të mesëm,*
- *Forcimi i mekanizmave të llogaridhënies dhe çertifikimit në sistem .*
- *Ngushtimi I hendekut gjinor në regjistrim, përfundim dhe rezultate mësimore në shkollim fillor dhe të mesëm*
- *Ndërmarrja e masave (politikave) për të ndihmuar vajzat dhe djemt në rrezik të braktisjes së shkollimit*
- *Krijimi I infrastrukturës arsimore që përmbush nevojat e nxënësve djem dhe vajza si dhe të mësueseve gra dhe burra*
- *Përkrahja e nxënësve djem/vajza përmes bursave ose mbështjetje tjetër financiare për arsimin teknik dhe profesional*

## Shëndetësia

Rrjeti shëndetësor në komunën e Vitisë është mjaft mirë i shpërndarë. Qytetarët e Vitisë për të marrë ndihmën dhe kujdesin primar shëndetësor, mund të drejtohen në gjashtë punkte të Mjekësisë Familjare (nëpër disa fshatra të kësaj komune), në katër qendra të mjeksis familjare ndërkohë që në qytetin e Vitisë ekziston Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare "Nëna Tereze", e cila për qytetarët e Vitisë ofron 24 orë shërbime.dhe ambulanta në fshatin Pozheran edhe kjo ambulant ofron 24 orë shërbime për qytetarët e Vitisë . Këto qendra e punkte, i mundësojnë Vitiasve që brenda 10-15 minutave të arrijnë deri në ambulancë ku mundë ti ofrohet kujdesi primar,shëndetësor.

**Në QKMF " Nëna Tereze"** kryhen këto shërbime:

- Shërbimi i përgjithshëm
- Shërbimi i mjekësisë familjare
- Shërbimi gjinekologjik
- Shërbimi internistik
- Shërbime rentgeni
- Shërbimi pediatrik-
- Shërbimi Stomatologjik dhe Shërbimi për vaksinim.

Kjo qendër ka rreth 145 të punësuar ( administrata 3 dhe QKMF-ja 142) ,

## Kultura

**Institucioni përgjegjës për zhvillimin e jetës kulturore në komunë e Vitisë është Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e cila organizohet nga këta sektor:**

- Sekori për Kulture,
- Sektori për Rini dhe Sport
- Sektori i Bibliotekës Publike Komunale
- Sektori i Arkivit Historik

Organizimet kulturo-sportive Statutare në kuadër të kësaj drejtorie janë:

- "Flakadani i Karadakut", 21-26 Mars
- "2 Korriku"- 18 Qershor- 2 Korrik
- Dita e çlirimit e Komunës së Vitisë, 14 Qershor
- 5 Maji, Dita e Dëshmorëve të Komunës së Vitisë etj.

Ndërkaq manifestimi kulturor, letrar e shkencor " Takimet e Dom Mikelit" është një manifestim tradicional me përmasa gjithëkombëtare. Ky manifestim organizohet nga Shoqata e Kulturore Shkencore "Dom Mikel Tarabulluzi" me qendër në fshatin Stubëll. Ky manifestim tradicional organizohet që nga viti 1990 dhe mbahet zakonisht të premten dhe të shtunën e parafundit të muajit shtator, në shenjë të shënimit të Shkollës së parë shqipe në Kosovë, më saktësisht në fshatin Stubëll 1584-1905 dhe në shenjë të përkujtimit të mësuesit të saj Dom Mikel Tarabulluzit, ndër aktivitete tjera të cilat organizohen apo mbështeten nga DKRS tradicionalisht janë: Ditët e Zojes së Bekuar, 17 Shkurti-Dita e Pavarësisë së Republikës së Kosovës, 3 Maji-Dita Botërore e Lirisë së Shtypit, 9 Maji- Dita e Evropës, 1 Qershori- Dita Ndërkombëtare e Femijëve, 15 Shtatori- Dita Ndërkombëtare e Demokracisë, 26 Nëntori- American Thanksgiving, 28 Nëntori- Dita e Flamurit Kombëtar, 8 Marsi- Dita Ndërkombëtare e Gruas, 7 Marsi- Dita e Mësuesit ndërsa nga kodi buxhetor i DKRS-se gjate vitit fiscal shpërndahen subvencionet sipas kërkesave ( thirrja publike).

Në kuadër të bibliotekës komunale të Vitisë ekziston një fond rreth 55.000 librash dhe atë në gjuhët: shqipe, serbokroate, angleze, frënge e turke). Në kuadër të kësaj biblioteke funksionon sektori për të rritur dhe të vegjël gjithashtu përveç fondit të librave tekstual kjo bibliotekë ka edhe fondin auditiv (për të verbër) por ky fond është vetëm në gjuhën angleze. Numri i lexuesve është gjithnjë në rritje dhe ky numër është afër 10.000,. Kjo bibliotekë është e vendosur në Shtëpinë e Kulturës "Bajram e Gursel Sylejmani" në Viti dhe gjithashtu në kuadër saj funksionon biblioteka në : Pozheran, dhe Sllatinë e Epërme.

## Rekomandime për objektiva dhe indikatorë gjinorë

**Disa nga objektivat, aktivitetet dhe indikatorët për tu ndërmarr nga komuna janë:**

**Objektiva**

- Rritja e përqindjes së femrave/grave të cilat përfitojnë nga subvencionet në sport, kulturë, dhe rini.

**Aktivitetet**

- Organizimi i një fushate vetdijësuese duke targetuar vajzat dhe gratë për rëndësinë e pjesmarrjes në aktivitete sportive, duke përfshirë këtu klubet e ndryshme sportive.

**Indikatorët gjinor**

- Rritja e numrit të klubeve sportive qe përbehen nga meshkuj dhe femra në së paku 3 gjatë vitit të ardhshëm.
- Rritja e numrit të klubeve sportive që përbehen nga femrat në se paku 3 gjate vitit të ardhshëm.
- Rritja minimum 20% e subvencioneve për klube sportive të femrave apo të atyre me përfitues të përzier meshkuj dhe femra.

**në secilin sektor, dhe buxheitn për kokë banori marrë për bazë statistkat gjinore të popullsisë.**

# III. Korniza Fiskale Komunale

3.1 Ndonëse komuna nuk udhëheqë drejtëpërdrejt politikën makroekonomike (kjo është kompetencë e qeverisë qendrore) mjedisi i përgjithshëm ekonomik ndikon në pasqyren fiskale komunale dhe si i tillë do të trajtohet si vijon, shih tabelën më poshtë. Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës është në përputhje me kornizën makroekonomike të Kosovës dhe sipas dokumentit Korniza Afatmesme të Shpenzimeve ( KASH-Qarkorja buxhetore ) 2026-2028 të përpiluar nga Qeveria e Kosovës.

Komponentet e politikës makroekonomike sic janë Bruto Produkti Vendor, inflacioni dhe domografia duhet konsideruar dhe marrë parasysh. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2026-2028 e Qeverisë së Kosovës bazuar në të dhënat historike si dhe në zhvillimet e fundit ekonomike dhe sociale të vendit .

*Me qarkoren buxhetore janë përcaktuar grantet qeveritare për financimin e komunave për vitin 2026 dhe orientimet për vitet 2027-2028, bazuar në prioritetet strategjike të Qeverisë në fushën e marrëdhënieve fiskale ndërqeveritare. Po ashtu, qarkorja përcakton edhe nivelin e të hyrave vetanake të komunave për vitin fiskal 2026 si dhe parashikimin afatmesëm 2027-2028.*

*Parimet, kriteret dhe formulat e zbatuara për ndarjen e granteve qeveritare për financimin e komunave për vitin 2026, bazohen në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal (LFPL) dhe Tabelën 1 të projeksioneve makro-fiskale, të përgatitur nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve siç specifikohet në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).*

*Me rastin e regjistrimit të popullsisë, të dhënat të cilat janë publikuar zyrtarisht nga Agjencia e Statistikave të Kosovës në vitin 2024, Qeveria e Republikës se Kosovës me datë 12.03.2025 ka aprovuar shtojcën 1 me të dhënat e reja nga regjistrimi i Popullsisë, në përputhje me nenin 35, paragrafi 2 të Ligjit N.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, të dhëna të cilat kanë shërbyer për përgatitjen e buxhetit komunal për vitin 2026-2028.*

*Procesi i buxhetit komunal merr parasysh këto aspekte:*

- *Buxhetimi në nivel të programeve dhe nën-programeve, në përputhje me strukturën ekzistuese të planit kontabël,*
- *Përmirësimet në qasjen e buxhetimit të orientuar drejt rezultateve dhe performancës,*
- *Zbatimi i konceptit shumë vjeçar mbi planifikimin e projekteve kapitale, si dhe*
- *Përcaktimi i strukturës së shpenzimeve sipas kategorive të shpenzimeve.*

*Projektet kapitale shumë vjeçare duhet të raportohen në sistemin e Projekteve të Investimeve Publike (PIP) bazuar në performancë. Si rrjedhojë, nga komunat kërkohet të hartojnë strategjinë kornizë bazuar në synimet dhe objektivat të orientuara në rezultate .*

Komuna nga ana e saj do të adaptojë legjislacionin përkatës në funksion të krijimit të ambientit më të mirë për sektorin privat dhe rritjes së të ardhurave të tyre, rrejdhimisht rritjes së të hyrave buxhetore komunale, rritjes reale duke pasur parasysh mbledhjen e të hyrave vetanake .

Aktualisht financimi komunal përfshinë: **1. Grantet qeveritar dhe 2. Të Hyrat Vetanake**

### 3.2 Tendenca e të hyrave komunale dhe parashikimi afat-mesëm 2026-2028

Buxheti i Komunës së Vitisë përbëhen nga dy burime kryesore.

1. **Grantet qeveritare dhe**
2. **Të hyrat vetanake komunale .**

Buxheti i Komunës në vitet (2024 – 2028)

Plan buxheti 2025-2028
Tabela nr. 1

Plan buxheti 2025-2028 QB2026/01

| ***Grantet*** | ***2025*** | ***2026*** | ***ndrysh 2025-2026*** | ***% 2025-2026*** | ***2027*** | ***2028*** | ***ndrysh 2026-2027*** | ***% 2026-2027*** | ***ndrysh 2026-2028*** | ***% 2026-2028*** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Granti i përgjithshëm** | **7,705,065** | **7,705,065** | - | - | **7,787,122** | **8,407,818** | 82,057 | ***1.06*** | 702,753 | ***9.12*** |
| **Granti specifik i Arsimit** | **6,887,646** | **7,199,958** | *312,312* | *4.53* | **7,415,957** | **7,638,436** | 215,999 | ***3.00*** | 438,478 | ***6.09*** |
| **Granti specifik i Shëndetsis** | **1,927,784** | **1,969,532** | *41,748* | *2.17* | **2,028,618** | **2,089,476** | 59,086 | ***3.00*** | 119,944 | ***6.09*** |
| Granti për sherbimet rezidenciale | **155,000** | **155,000** | - | - | **200,000** | **200,000** | 25,000 | ***16.13*** | 25,000 | ***16.13*** |
| THV | **1,270,127** | **1,294,660** | **24,533** | *1.93* | **1,390,801** | **1,396,962** | 96,141 | *7.43* | 102,302 | *7.90* |
| Totali | **17,945,622** | **18,324,215** | **378,593** | ***2.11*** | **18,822,498** | **19,732,692** | ***498,283*** | **2.72** | ***1,408,477*** | **7.69** |

diferenca

| Fondet | **2025** | **2026** | ***ndrysh 2025-2026*** | ***%*** | **2027** | **2028** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Grantet qeveritare | **16,675,495** | **17,029,555** | **354,060** | **92.93** | **17,431,697** | **18,335,730** |
| Të hyrat vetanake | **1,270,127** | **1,294,660** | **24,533** | **7.07** | 1,390,801 | 1,396,962 |
| Totali | **17,945,622** | **18,324,215** | **378,593** | **100** | **18,822,498** | **19,732,692** |

| ***Grantet*** | ***2025*** | ***2026*** | ***2027*** | ***2028*** |
|---|---|---|---|---|
| **Granti i përgjithshëm** | **7,705,065** | **7,705,065** | 7,787,122 | 8,407,818 |
| **Granti specifik i Arsimit** | **6,887,646** | **7,199,958** | 7,415,957 | 7,638,436 |
| **Granti specifik i Shëndetësis** | **1,927,784** | **1,969,532** | 2,028,618 | 2,089,476 |
| Granti për sherbimet rezidenciale | **160,000** | **155,000** | 200,000 | 200,000 |
| THV | **1,270,127** | **1,294,660** | 1,390,801 | 1,396,962 |
| Totali | **17,950,622** | **18,324,215** | **18,822,498** | **19,732,692** |

| | |
|---|---|
| **92.93** | **% Grantet** |
| **7.07** | **% THV** |
| **100** | **%** |

Buxheti i vitit 2026 në krahasim me buxhetin e vitit 2025 në tërësi ka shënuar rritje prej 2.11%. Buxheti në vitin 2025 është në shumë prej 17,945,622 €, vitin 2026 është në shumë prej 18,324.215 € , vitin 2027 është 18,822,498 € , dhe në vitin 2028 prej 19,732,692 €.

Këto të dhëna kryesisht bazohen në të dhënat e përgjithshme buxhetore që planifikohen në nivel të Qeverisë nacionale, sic parashihet me KASH-in 2026-2028. Rritja për vitin 2026 është reflektuar në grantin specifik të arsimit në shumë prej 312,312 € ( 4.53 % ) , rritje në grantin e shëndetësis në vlerë prej 41,748 € ( 2.17%), dhe të hyrat vetanake kanë reflektuar rritje në vlerë prej 24,533 € ( 2.11 % ).

Në vitin 2026 kemi rritje në total grantet operative ( granti i përgjithshëm, granti specifik i shëndetsis ,grantin spefifik të arsimit ) kemi rritje në vlerë prej 354,060 € .

Të hyrat vetanake komunale në krahasim me vitin 2025 në vitin 2026 kemi rritje në vlerë prej 24,533 €, janë të planifikuara në vlerë prej 1,294,127 €, po ashtu në vitin 2027 janë të planifikuara në vlerë prej 1,390,801 €, për vitin 2028 janë në vlerë prej 1,396,962 € ( kufijt e caktuar nga komisioni i granteve në nivel ndërqeveritar Qarkore buxhetore e komunave 2026/01).

Tabela nr.2: Planifikimi i të hyrave komunale sipas burimit për vitet 2025-2028

| | Komuna: Viti | Grantet dhe THV - 2025 | Grantet dhe THV 2026 | Grantet dhe THV 2027 | Grantet dhe THV 2028 |
|---|---|---|---|---|---|
| | | në Euro | në Euro | në Euro | në Euro |
| | **Burimet e të Ardhurave** | | | | |
| | **GRANTET** | **16,675,495** | **17,029,555** | **17,431,697** | **18,335,730** |
| 1. | Granti i Përgjithshëm | 7,705,065 | 7,705,065 | 7,787,122 | 8,407,818 |
| 2. | Granti i Arsimit | 6,887,646 | 7,199,958 | 7,415,957 | 7,638,436 |
| 3. | Granti i Shëndetësisë | 1,927,784 | 1,969,532 | 2,028,618 | 2,089,476 |
| 4. | Granti për sherbimet rezidenciale (Financimi për shtëpitë e komunitetit për personat me aftësi të kufizuar) | 155,000 | 155,000 | 200,000 | 200,000 |
| | **TOTALI I TË HYRAVE KOMUNALE** | **1,270,127** | **1,294,660** | 1,390,801 | 1,396,962 |
| | **TOTAL BUXHETI PËR VITE** | **17,945,622** | **18,824,215** | **18,822,498** | **19,732,692** |
| | **Burimet e të Ardhurave të Tëhyrave vetanake** | **viti 2025** | **viti 2026** | **viti 2027** | **viti 2028** |
| | Sherbimi i arhivit | 1,500 | 1,500 | 1,500 | 1,500 |
| | Dokumentet zyrtare ofiqarija(qertifikatat e lindjes) | 3,000 | 3,000 | 3,000 | 3,000 |
| | Kunorëzimi | 4,000 | 4,000 | 4,000 | 4,000 |
| | *Çerifikata të vdekjes* | *500* | *500* | *500* | *500* |
| | *Vërtetimi I origjinalitetit te dokum.* | *200* | *200* | *200* | *200* |
| | *T.H. tjera ofiqarije* | *69,300* | *50,000* | *60,000* | *60,000* |
| | **Totali i Administrates** | **78,500** | **59,200** | **69,200** | **69,200** |
| | *Qiraja nga hapsira publike* | *15,000* | *15,000* | *15,000* | *15,000* |
| | *Shfrytëzimi i hapësirës publike* | *7,410* | *7,410* | *7,410* | *7,410* |
| | *Reklamat* | *2,800* | *2,800* | *2,800* | *2,800* |
| | *Parkim publik* | *1,200* | *1,200* | *1,200* | *1,200* |
| | *Taksë për licenca autotaksive* | *2,000* | *2,000* | *2,000* | *2,000* |
| | **Totali i Sherbimeve Publike** | **28,410** | **28,410** | **28,410** | **28,410** |
| | *Lejet e Ndertimit* | *90,000* | *100,000* | *100,000* | *100,000* |
| | *Lejet mjedisore* | *2,000* | *2,000* | *2,000* | *2,000* |
| | *Takse per legalizim objekteve* | *153,000* | *123,744* | *143,165* | *143,165* |
| | **Tot.Urbanizmit** | **245,000** | **225,744** | **245,165** | **245,165** |
| | *Tatimi në pronë* | *458,993* | *503,696* | *540,214* | *545,616* |
| | *Tatimi në tokë* | *107,272* | *125,464* | *151,812* | *152,571* |
| | *Rexhistrimi i automjeteve* | *117,271* | *118,000* | *120,000* | *120,000* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Tot.Ekonomi, Financa** | **683,536** | **747,160** | **812,026** | **818,187** |
| *Fleta poseduese dhe kopje plani* | *30,000* | *30,000* | *30,000* | *30,000* |
| *Bartja e pronësisë* | *35,000* | *35,000* | *35,000* | *35,000* |
| *Daljet në teren* | *23,181* | *24,146* | *26,000* | *26,000* |
| **Totali Kadastër- gjeodezi** | **88,181** | **89,146** | **91,000** | **91,000** |
| *Participim nëshëndetësia* | *85,000* | *80,000* | *80,000* | *80,000* |
| *Vërtetime nga QPS-ja* | *2,800* | *2,800* | *2,800* | *2,800* |
| **Tot.Shendetesi** | **87,800** | **82,800** | **82,800** | **82,800** |
| *Të hyrat nga qerdhja* | *41,000* | *45,000* | *45,000* | *45,000* |
| *Të hyrat nga shkollat e mesme* | *2,000* | *2,000* | *2,000* | *2,000* |
| **total.Arsimit** | **43,000** | **47,000** | **47,000** | **47,000** |
| *Të hyrat nga sht.kultures* | *500* | *1,000* | *1,000* | *1,000* |
| *Te hyrat nga arhivi historik* | *500* | *1,000* | *1,000* | *1,000* |
| **Totali i Kultures** | **1,000** | **2,000** | **2,000** | **2,000** |
| *Shitja e masës drurore* | *2,400* | *2,400* | *2,400* | *2,400* |
| *Shenderrimi i tokes buj.-nde.* | *6,300* | *6,300* | *6,000* | *6,000* |
| *Vertetimi per marrje me veprimtari bujqesor* | *200* | *200* | *500* | *500* |
| **Totali i Bujqesise** | **8,900** | **8,900** | **8,900** | **8,900** |
| *Inspektimi i tregut* | *1,000* | *1,000* | *1,000* | *1,000* |
| *Gjobat nga inspekcioni* | *800* | *1300* | *1300* | *1300* |
| *Shiqimi i autotaksive* | *1,500* | *1,500* | *1,500* | *1,500* |
| *Pranimi teknik i lokaleve* | *4,000* | *2,000* | *2,000* | *2,000* |
| **Totali i Inspeksionit** | **5,800** | **4,300** | **4,300** | **4,300** |
| **Totali i përgjithshëm** | **1,270,127** | **1,294,660** | **1,390,801** | **1,396,962** |

Në planifikimin e buxhetit nuk kalkulohen të hyrat e nivelit qëndror - të hyrat indirekte por vetëm të hyrat direkte.

Buxheti komunal vazhdon të dominohet nga transferet qeveritare në tri vitet e ardhshme do të përbëjnë afërsisht 92.93 % (17,029,555) € ) të buxhetit total të komunës kurse nga të hyrat vetanake të komunës me 7,07 % ( 1,294,660) € ) .

| | Shuma në € | në % |
|---|---|---|
| Transferet qeveritare/grantet | **17,029,555** | 92.93 |
| Të hyrat vetanake Komunale | **1,294,660** | 7.07 |
| Totali | **18,324,215** | 100,00 |

## 3.3 Politikat e reja

**Së pari** - Komuna e Vitisë në tri vitet e ardhshme do të bëjë përpjekje në mobilizimin e resurseve komunale me qëllim të adaptimit të politikave të reja që ka inicuar Qeveria e Republikës së Kosovës, gjithmonë duke e pasur në prioritet përsepktivën gjinore, por edhe të atyre të inicuara në nivelin e qeverisë komunale.

Me këtë Qarkore përcaktohen grantet qeveritare për financimin e komunave për vitin 2026 dhe orientimet për vitet 2027-2028, bazuar në prioritetet strategjike të Qeverisë. Po ashtu, kjo Qarkore përcakton nivelin e të hyrave vetanake të komunave për vitin fiskal 2026 si dhe parashikimin afatmesëm 2027-2028.

Parimet, kriteret dhe formulat e zbatuara për ndarjen e granteve qeveritare për financimin e komunave për vitin 2026, bazohen në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal (LFPL) dhe Tabelën 1 të projeksioneve makro-fiskale, të përgatitur nga Ministria e Financave siç specifikohet në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP). Komisioni i Granteve në kuadër të MFPT ka aprovuar financimin komunal për vitin 2026 dhe projeksionet për vitin 2027-2028.

**Procesi i buxhetit komunal merr parasysh këto aspekte:**

- Buxhetimi në nivel të programeve dhe nën-programeve, në përputhje me strukturën ekzistuese të planit kontabël dhe buxhetimit sensitiv gjinor
- Përmirësimet në qasjen e buxhetimit të orientuar drejt rezultateve dhe performances (gjithmonë duke u bazuar në perspektivën gjinore),
- Zbatimi i konceptit shumëvjeçar mbi planifikimin e projekteve kapitale që ju shërbejnë qytetarëve pa dallime në baza gjinore, si dhe
- Prezentimi i struktures së shpenzimeve sipas kategorive të shpenzimeve për vitin 2026 dhe projekcionet e vitit 2027 dhe 2028.

Komunat janë të obliguara të përgatisin Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale për vitin 2026-2028, dhe të aprovojnë në Kuvendin Komunal para datës 30.06.2025 si dokument strategjik komunal, i cili dokument bazohet në synimet dhe objektivat të orientuara në rezultate si dhe pasqyron caqet e përgjithshme të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore si dhe strukturën e shpenzimeve sipas kategorive të shpenzimeve.

Ndonëse ende nuk është pjesë e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Qeverisë së Kosovës 2026-2028, sygjerimet të Qeverisë së Kosovës janë që shuma e Grantit të Përgjithshëm të komunave që aktualisht është nën dhjetë përqind e të hyrave totale të buxhetuara të Qeverisë qendrore, (duke përjashtuar mbështetjen buxhetore dhe grantet, të hyrat nga tatimi në pronë dhe tokë, të hyrat nga interesi si dhe taksat, ngarkesat tjera të qeveris lokale. Bazuar në tabelën nr të qarkores buxhetore 2026/01 të përgaditur nga Departamenti i politikave ekonomike, publike dhe bashkëpunimit ndërkombëtar financiar të ministris së financave në përputhje me LFPL, granti i përgjithshëm për komuna për vitin 2026 është aprovuar nga komisioni i granteve në shumë prej 345.02 milion €. Kjo ndarje bazohet në formulen e përcaktuar nga neni 24 të LFPL , sipas këtij neni 10% e të hyrave totale të buxhetuara të qeveris qëndrore ju ndahen komunave duke përjashtuar mbështetjen buxhetore dhe grantet , te hyrat nga tatimi në pronë e tokë, interesi, taksat, dhe të hyrat vetanake të komunave( shih QB-2026/01 faqe 11).

Me qëllim të nivelizimit të kapacitetit të ulët të të hyrave vetanake të komunave më të vogla, bazuar në LFPL, secila komunë do të pranojë për çdo vit një shumë të përgjithshme fikse prej 140,000 euro, duke zbritur nga 1 euro për kokë banori ose 0 euro për komunat me popullsi të barabartë ose më të madhe se 140,000 banorë. Pas kësaj, shpërndarja e bërë nëpër komuna bazohet në formulën për alokimin e grantit të përgjithshëm në komuna sipas LFPL: (i) numri i popullsisë llogaritet me tetëdhjetë e nëntë përqind (89%); (ii) përmasat gjeografike të komunës me gjashtë përqind (6%); (iii) numri i popullsisë pakicë në komunë me tre përqind (3%); (iv) komunat ku shumica e popullsisë së të cilave përbëhet nga pakicat me dy përqind (2%).

Financimi i shërbimeve sociale si kompetencë e transferuar nga MPMS në komuna duhet të financohet nga granti i përgjithshëm komunal. Të punësuarit në administratën e Drejtorive Komunale për Arsim parauniversitar dhe Shëndetësi primare financohen nga granti i përgjithshëm në komuna. Po ashtu mund të financohen të

plotësohen nga granti i përgjithshëm edhe grantet specifike për arsim para universitar dhe shëndetësi primare kur është e nevojshme.

**Projeksionet e bëra për vitin 2026 dhe vlerësimet për vitin 2027 dhe 2028 në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve të Kosovës, reflektojnë rritje të grantit qeveritar në bazë të qarkores buxhetore 2026/01 në këto grante si :**

**Granti specifik i arsimit ka shënuar rritje në vlerë prej ................................ 312,312 €,**
**Granti specifik i shëndetsisë ka shënuar rritje në vlerë prej ........................ 41,768 €,**
**Granti i shërbimeve rezidenciale i njëjt.**

**Totali i rritjes së granteve është në shumë prej 354,060 €.**

**Shuma e të hyrave vetanake është e rritun nga viti 2025 prej 24,533 €.**

**Së dyti** - Komuna e Vitisë ka rritje të granteve në në shumë prej 354,060 € shih QB 2026/1 faqe13 ), implementimi i ndryshimeve ligjore të cilat bartin kosto shtesë të shpenzimeve në të cilën është përfshirë edhe kostoja nga regjistrimi i popullsisë në shumë prej 6.5 milion euro, për të mbuluar ndikimin negativ në disa komuna, bazuar në nenin 35.3 të LFPL.
Kjo ndarje bazohet në formulën e përcaktuar në nenin 24 të LFPL. Sipas këtij neni, 10% e të hyrave totale të buxhetuara të Qeverisë qendrore ju ndahen komunave, duke përjashtuar: mbështetjen buxhetore dhe grantet, grantet e përcaktuara të donatorëve, të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga interesi si dhe taksat, ngarkesat dhe të tjera nga qeveria lokale.

Siç paraqitet në tabelën në vijim, bazuar në vlerësimet të Departamentit të Politikave Ekonomike, Publike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar, të hyrat e përgjithshme qeveritare për vitin 2026 pritet të jenë 3,544.3 mil. euro. Nga kjo shumë, zbriten ato të hyra siç specifikohet në nenin 24 të LFPL dhe vijmë tek baza për ndarjen e grantit të përgjithshëm për komuna, i cili grant për vitin 2026 është në shumë prej 338.53 milion euro.

**Së treti** - Në rast se në periudhën afatmesme Qeveria e Kosovës do të ndryshojë formulën shteterore të ndarjes së grantit të arsimit për Komuna, ndarje kjo që është bërë në qarkoren buxhetore 2025/01 në bazë të numrit të nxënësve ( për komunën tonë prej 7,026 ( 7,026-6,812 = 214 ) në vitin 2026 çka do të thotë se kemi 214 nxënës më pak se në vitin 2025.
Financimi i programit të administratës së arsimit, administratës së shëndetësis dhe shërbimeve sociale bëhet nga granti i përgjithshëm .

Granti Specifik për Arsim para universitar sipas LFPL, bazohet në sistem të hapur të financimit, duke marrë parasysh kriteret në formulën e arsimit para universitar të MASHTI për vitin 2026-2028.
Grantin specifik për arsim para universitar për vitin 2026 është në shumë prej 270.46 milion euro, si vijon:
1. Granti bazë në shumë prej 265.9 milion euro si vijon:
- Paga dhe shtesa në shumë prej 247.4 milion euro,
- Mallra dhe shërbime në shumë prej 16.75 milion euro,

- Shpenzime kapitale në shumë prej 2.1 milion euro.

2. Politikat e reja të aprovuara janë si në vijim:
a) Transporti i nxënësve nga klasa 0-9, me kosto prej 3,48 milion euro,
b) Numri i personelit ndihmës për çerdhet e reja, rritje të stafit prej 138 dhe kosto për paga dhe shtesa prej 0.9 milion euro.

Formula trajton nivelin e arsimit parafillor, fillor dhe të mesëm, duke marrë për bazë këto kritere:
a) Numri i nxënësve të regjistruar për vitin 2024/2025;
b) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm për nxënësit shumicë 1:21.3 (bazuar në Udhëzimin administrativ nr. 22/2013 të MASHTI-it);
c) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm për nxënësit pakicë 1:14.2;
d) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin parashkollor 1:12;
e) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin e mesëm profesional për nxënësit shumicë 1:17.2, dhe për nxënësit pakicë 1:11.5;
f) Raporti nxënës-mësimdhënës për zonat malore 1:14.2;
g) Kalkulimi për stafin mësimdhënës të gjuhës angleze për klasën I dhe II;
h) Kalkulimi për stafin teknik administrativ për 630 nxënës 1 staf në arsimin parafillor dhe fillor;
i) Kalkulimi për stafin teknik administrativ për 470 nxënës 1 staf në arsimin e mesëm
j) Kalkulimi për stafin ndihmës për 170 nxënës 1 staf (pastrues) si dhe 1 staf për shkollë (roje);
k) Kalkulimi i pagave dhe shtesave është bazuar në Ligjin për Paga në sektorin Publik;
l) Shërbimi profesional Pedagogjik/Psikologjik;
m) Koordinatorët e cilësisë;
n) Mallrat dhe shërbimet janë kalkuluar sipas kriterit për nxënës (23 euro për nxënës shumicë dhe 25 euro për nxënës pakicë) dhe për shkollë (1,500 euro për shkollë parafillore dhe fillore dhe 3,250 euro për shkollë të mesme);
o) Kapitalet janë kalkuluar sipas kriterit 7 euro për nxënës;
